



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në  
“Ekonomiks”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Epoka”

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Phd Esmeralda Shehaj

2. Prof. Dr. Raimonda Duka

Shtator 2022



**Për Programin e studimit në Master i Shkencave në “Ekonomiks”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Epoka”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Msc në Ekonomiks
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH nr.517, datë 17.10.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UrdhërMASH Nr.565, datë 2011-11-22
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr.273, datë 24.05.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.A 2021-2022 - 6 PAE/4 PAK V.A 2020-2021 – 11 PAE/3 PAK
18	Numri i studentëve:	V.A 2021-2022 - 5 të rregjistruar V.A 2020-2021 - 9 të rregjistruar
19	Komente / të tjera:	-

*Shqipëri* *Ascal*



## **Përshkrim përmbledhës**

Universiteti “Epoka” është institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 281, datë 12.03.2008. Universiteti “Epoka” zhvillon veprimtarinë e tij në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Universiteti “EPOKA” ka kaluar procesin e akreditimit periodik, proces i zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.54, date 16.12.2021, me vlerësim përfundimtar pozitiv, me kohëzgjatje 6 vite akademike dhe me afat vlefshmërie deri në 15.12.2027.

Universiteti “Epoka”, është i organizuar në 3 fakultete, 2 Qendra kërkimore dhe 8 departamente. Fakultet në përbërje të Universiteti “Epoka”, janë :

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë;
2. Fakulteti i Ekonomisë dhe Shkencave Administrative;
3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale

Ky raport paraqet vlerësimin e jashtëm për programin e studimit Master Shkencor në “Ekonomiks” licensuar me Urdhërin Nr. 517, datë 17.10.2011. Programi i studimit është akredituar për herë të parë në bazë të Urdhërit të Bordit të Akreditimit Nr.273, datë 24.05.2016. Kohëzgjatja e këtij akreditimi është 6 vite, me afat 23.05.2022.

Programi i studimit Master Shkencor në “Ekonomiks” ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FEAS).

FSHEA është i organizuar në tre departamente:

1. Departamenti i Ekonomiksit;
2. Departamenti i Financë – Bankës;
3. Departamenti i Administrim – Biznesit.

Departamenti i Ekonomiksit ofron programe studimi në të tre ciklet e studimit si më poshtë:

1. Bachelor në Ekonomiks;
2. Master i Shkencave në Ekonomiks;
3. Doktoratë në Ekonomiks.

Programi i studimit Msc në Ekonomiks, pranë Universitetit Epoka, është hartuar për të plotësuar nevojën për specialistë të kualifikuar në këtë fushë dhe për të përgatitur persona të aftë për të punuar në sektorë të ndryshëm që lidhen me ekonominë. Masteri i Shkencave në Ekonomi kombinon një kurrikulë me lëndë të formimit të përgjithshëm, formimit bazë, karakterizues si dhe lëndë me zgjedhje të përshtatura për fushat e veçanta të interesit të studentit që të përmbushin sfidat e tregut të punës. Programi i studimit është i strukturuar në dy vite akademike, në 4 semestra dhe përfshin 120 ECTS. Mësimdhënia në këtë program studimi realizohet në gjuhën angleze.



## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, përzgjedhi dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UE, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Raimonda Duka dhe Prof.Asoc.PhD. Esmeralda Shehaj. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknike e ASCAL, Msc. Arjana Alija.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Shkencor në “Ekonomiks” të ofruar nga Departamenti i Ekonomiksit pranë Universitetit “Epoka”, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të këtij raporti. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një numër pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat morën përgjigje gjatë takimeve që u realizuan në IAL.

Vizita një ditore në Universitetin “Epoka”, u realizua në datën 17/02/2022, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL.

Gjatë vizitës, në Universitetin “EPOKA”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Dekanin e FSHEA dhe Përgjegjësin e Departamentit të Ekonomiksit, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar, përfaqësues të Zyrës së Hulumtimit dhe Projekteve si dhe me sekretarinë mësimore. GVJ zhvilloi gjithashtu një takim me studentët e programit të studimit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit Master Shkencor në “Ekonomiks”, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët drejtuan pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacionin e depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzoi draft-raportin pranë ASCAL.

## **SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

IAL nuk ka patur rekomandime nga akreditimi i parë.



“Universiteti Epoka” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02/08/2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 29/37 Prot. datë 02/08/2022. “Universiteti Epoka” përcjell në ASCAL komentet përmes AMS dhe me anë të shkresës me Nr. 097/4 Prot., datë 11/08/2022, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”.

**GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si më poshtë:**

- 1. Lidhur me Standardin I.3, kriteri 2** komenti i GVB nuk kundërshton gjetjen e raportit, por vetëm konfirmon që Zyra e Karrierës dhe Alumni dhe Departamenti i Ekonomiksit do të angazhohen për të zbatuar rekomandimin e dhënë në raport për të kryer studimin e tregut. GVJ i qëndron gjetjeve dhe rekomandimit dhe raporti nuk ndryshon.
- 2. Lidhur me Standardin I.3, kriteri 2** GVB konfirmon gjetjen e raportit dhe shprehet që Institucioni do të bëjë rishikim kurrikule për vitin akademik 2022-2023. Raporti në lidhje me këtë kriter mbetet i pandryshuar.
- 3. Lidhur me Standardin I.5, kriteri 4 dhe kriteri 5** GVB konfirmon gjetjen e raportit dhe shprehet që Institucioni do të bëjë rishikim kurrikule për vitin akademik 2022-2023. Raporti në lidhje me këtë kriter mbetet i pandryshuar.
- 4. Lidhur me Standardin I.6, kriteri 4** GVJ konfirmon që gjetjet e tij janë mbështetur në dokumentacionin e përfshirë në dosjen e dorëzuar në systemin AMS të ASCAL. Standardi është vlerësuar si i përmbushur plotësisht nga dhe GVJ i qëndron vlerësimit të dhënë në raport.
- 5. Lidhur me Standardin II.1, kriteri 5 dhe kriteri 6** GVB konfirmon gjetjen e raportit dhe shprehet që Institucioni do të bëjë rishikim kurrikule për vitin akademik 2022-2023. Raporti në lidhje me këtë kriter mbetet i pandryshuar.
- 6. Lidhur me Standardin III.I, kriteri 4** GVB ka pranuar sugjerimin për përfshirjen e rezultateve të vlerësimeve në raportet vjetore të Departamentit të Ekonomiksit. Shtojca e re e dorëzuar tregon që raportet vlerësuese ekzistojnë, gjë që është konstatuar më parë nga GVJ dhe është shkruar në raport që këto raporte janë publike në faqen e internetit. Gjithsesi, mbetet ende i paformalizuar mekanizmi se si këto rezultate përdoren për të përmirësuar mësimdhënien.
- 7. Lidhur me Standardin III.3, kriteri 5** GVB konfirmon gjetjet e raportit dhe shprehet se konstatimi i GVJ do të përcillet. Për sa me sipër, raporti në lidhje me këtë kriter mbetet i pandryshuar.
- 8. Lidhur me Standardin III.4, kriteri 1**, GVB pranon rekomandimin për përfshirjen e vlerësimeve të studentëve në raportet vjetore të Departamentit, dhe sqaron se këto përcillen në dekanat dhe më pas në rektorat. Gjithsesi, standardi është vlerësuar si i përmbushur plotësisht nga dhe GVJ i qëndron vlerësimit të dhënë në raport.



**9. Lidhur me Standardin III.6, kriteri 5** GVB sqaron se në Guidën e Stafit specifikohen oraret e konsultimeve që mund të përdoren për komunikim me pedagogun. GVJ konstaton se procedura mbetet në diskrecionin e pedagogut dhe mungon një procedurë e qartë e adresimit të komenteve të studentëve për përmirësim. Gjithsesi, standardi është vlerësuar si i përmbushur plotësisht nga dhe GVJ i qëndron vlerësimit të dhënë në raport.

*Auty E. Shetaj*





## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Ekonomiks”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që ënojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti EPOKA synon të jetë një institucion mësimor dhe kërkimor inovativ dhe me ndikim, në shërbim të vlerave themelore njerëzore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të njohurive në nivel ndërkombëtar, si dhe të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale. Ndërsa Departamenti i Ekonomiksit, si njësi bazë në përbërje të institucionit synon kualifikimin e stafit të ri me njohuri të përgjithshme që i përgjigjen sfidave në ekonomi dhe të aftë për të punuar në administrimin e kompanive private vendase dhe të huaja. GVJ mbështetur në dokumentat strategjik të IAL dhe planin strategjik të Departamentit të Ekonomiksit konkludon që PS i ofruar nga UE mbështetet dhe mbron vlerat dhe interesat kombëtare.  <i>[Aneks: 3. Institution Development Strategy, fq. 6; Aneks 4. The strategic plan for the development of the program]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	UE ofron disa programe studimi në fushën e ekonomisë, teknologjisë së informacionit dhe inxhinierisë, të cilat janë fusha të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë kombëtare dhe ku punësohen aktualisht një pjesë e rëndësishme e studentëve të diplomuar. PS-t të ofruara nga IAL përputhen gjithashtu me strategjinë e punësimit të qeverisë shqiptare 2019-2022 në të cilën evidentohet që rritja e punësimit është arritur kryesisht nga rritja e sektorëve si: turizmi dhe tregtia, shërbimet shëndetësore dhe administrative, shërbimet në fushën e IT etj. Si pjesë e PS studentët realizojnë projekte, detyra dhe esse të orientuara drejt sfidave dhe nevojave të ekonomisë shqiptare. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në institucion konstatoi që IAL e mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në traditat më të mira kulturore, arsimore dhe shkencore të vendit. <i>[Aneks 3. Institution Development Strategy, fq.12-13]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Vizioni i UE është të jetë një institucion lider në fushën e edukimit, kërkimit dhe zhvillimit. Në planin strategjik të IAL-së dhe planin



<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>strategjik të departamentit janë përcaktuar qëllimet dhe objektiva për periudhën afatmesme 2018-2022. IAL synon të përgatisë individë të kualifikuar, të orientuar drejt hulumtimit shkencor, të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare. Konkretizimi i misionit mbështet në arritjen e disa synime kryesore si: përgatitjen e specialistëve të lartë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të shoqërisë; ofrimin e studimeve të thelluara akademike dhe kryerjen e hulumtimeve në fusha të ndryshme; integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor; sigurimin e një kualifikimi të vazhdueshëm dhe bashkëkohor për stafin akademik; të ndihmojë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal; etj. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit.</p> <p><i>[Aneks 3. Institution Development Strategy, fq. 9-15; Aneks 4. The strategic plan for the development of the program]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Universiteti EPOKA ofron programe studimi të ciklit të dytë në të tre Njësitë kryesore. Për të realizuar misionin strategjik UE ka përcaktuar ndër të tjera si qëllim kryesorë të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal. Programet e studimit të ofruara mbështesin dhe nxisin zhvillimin e vendit dhe janë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale. Në PS “Msc Ekonomiks” përfshihen lëndë që analizojnë veprimtarinë e institucioneve ekonomike kombëtare dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p><i>[Aneks 2. The Statute of HEI, neni 3, pika 7, fq.4; Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabela 9]</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Plani mësimor i PS përmban disa lëndë karakterizuese të nivelit ndërmjetëm dhe të avancuar, të cilat mundësojnë studime të thelluara të ciklit të tretë. Departamenti gjithashtu ka organizuar leksione të hapura, konferenca dhe aktivitete të tjera në funksion të krijimit të njohurive të qëndrueshme për studentët. <i>[Aneks 14. Diploma Supplement Model; Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabela 9]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>





<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i disa dokumentave të hartuara dhe miratuara nga institucioni, si Strategjia dhe Plani i veprimit të zhvillimit të institucionit 2018-2022; Plani Strategjik i Departamentit të Ekonomiksit 2017-2022, Statuti i IAL dhe kurrikula e PS, GVJ konstatoi që PS “Msc në Ekonomiks” është konceptuar në harmoni me vizionin dhe misionin e UE. Qëllimi dhe objektivat e PS janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përfshira në dokumentat strategjik, statutin e IAL dhe të gjitha aktet e nxjerra për zbatimin e tij.</p> <p><i>[Aneks 3. Institution Development Strategy; Aneks 4. The strategic plan for the development of the program; Aneks: 2. The Statute of HEI, neni 3; Aneks 13. Curricula of the study program]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në statutin e IAL janë përcaktuar drejtimet prioritare akademike të cilat janë në fushën e ekonomisë, shkencave inxhinjerie, shkencave sociale dhe drejtësisë. Njësitë kryesore ofrojnë programe studimi të cikleve të ndryshme. GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe gjatë takimit me drejtuesit e Njesisë bazë dhe Njesisë kryesore konstatoi se PS është ofruar dhe zbatohet duke u mbështetur në strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe planin strategjik të departamentit, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e IAL-së.</p> <p><i>[Aneks: 2. The Statute of HEI, neni 3]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>PS "Msc në Ekonomiks" është program studimi i ciklit të dytë, me nivel kualifikimi 7 sipas kornizës shqiptare të kualifikimit, është organizuar në katër semestra dhe realizohet me 120 ECTS. Përmbajtja, struktura dhe organizimi i PS është në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi për programet e studimit të ciklit të dytë. Statuti i IAL-së dhe dokumentat e PS (plani mësimor i programit dhe suplementi i diplomës) japin të dhëna të plota mbi strukturën dhe përmbajtjen e PS. Nga shqyrtimi i këtyre dokumentave GVJ konstatoi se PS është organizuar në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p> <p><i>[Aneks: 2. The Statute of HEI, neni 89-93; Aneks 13. Curricula of the study program; Aneks 14. Diploma Supplement Model]</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 mbështet në katër shtylla: rritja e stabilitetit ekonomik dhe fiskal, rritja nëpërmjet shtimit të konkurrueshmërisë; investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezionin social, si dhe rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve të zhvillimit territorial. Ndërsa qëllimi i PS "Msc në Ekonomiks" është formimi i aftësive analitike dhe teknike të studentëve për të zbatuar parimet e ekonomisë, i cili ndikon në formimin e kapitalit njerëzor duke përgatitur specialistë të fushës së ekonomisë. GVJ konkludoi që hartimi i PS përputhet me objektivat strategjike kombëtar dhe njëkohësisht mban në konsideratë praktikatat ndërkombëtare në zhvillimin e këtyre programeve.</p> <p><i>[Aneks 14. Diploma Supplement Model]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.3</b>  <b>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ënon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>PS "Msc në Ekonomiks" pajis studentët me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi për kërkim shkencor në fushën e ekonomiksit. Objektivi specifik i këtij programi studimi është të plotësojë nevojat për njerëz të kualifikuar në këtë fushë dhe t'i aftësojë ata për të punuar në sektorë të ndryshëm që lidhen me ekonominë. Në këtë program studimi studentët marrin njohuri të thelluara në fushën e ekonomiksit dhe aftësohen për të kryer studime dhe analiza që lidhen me politikatat e zhvillimit, politikën monetare dhe fiskale, si dhe veprimtarinë e tregjeve të ndryshme.</p> <p><i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University “Regulation on Second Cycle Study Programs”, Aneks 13. Curricula of the study program]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstatoi që IAL nuk ka kryer vet një studim mbi tregun e punës, por ka mbajtur në konsideratë shumë dokumenta politike, strategji dhe raporte për tregun e punës të hartuara nga institucione publike dhe organizata ndërkombëtare mbi zhvillimin e tregut të punës në Shqipëri.</p>



<p>të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit ka realizuar një hulumtim mbi punësimin e të diplomuarve në tregun e punës, në të cilën janë përfshirë dhe studentët e këtij programi studimi. Sipas këtij hulumtimi rezulton që 33.3% e të diplomuarve në këtë program janë të punësuar në sektorin publik dhe 66.7% në sektorin privat. GVJ konstatoi që numri i të diplomuarve në këtë program studimi është 28 studentë për periudhën 2017-2021. [Aneks 15. Study on the labor market before the opening of the program; Aneks 17. Update Alumni Records, fq.26; Aneks: Tabelat Përmbledhëse, tabela 21]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit u krijon studentëve mundësinë të thellojnë dijet e marra mbi ekonominë në ciklin e parë të studimeve. PS ofron dije të përshtatshme për ciklin e dytë të studimeve dhe gjithashtu i orienton studentët drejt kërkimit shkencor, por dhe kalimin në tregun e punës. Në disa lëndë zgjerohen dhe thellohen njohuritë e marra në ciklin e parë, ndërsa në program janë përfshirë dhe lëndë që ndihmojnë në specializimin e studentëve dhe zhvillimin e kompetencave për të punuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë siç është sektori bankar dhe Banka Qëndrore, kompanitë e sigurimit, në grupe që merren me hartimin e politikave, në parashikimin e zhvillimit të ekonomisë dhe treguesve kryesore për matjen e saj. [Aneks 13. Curricula of the study program]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Hartuesit e PS kanë mbajtur në konsideratë programe të ngjashme të ofruara në institucione të tjera kryesisht ato amerikane. Lëndët e detyruara janë të ngjashme me ato të programeve të tjera, ndërsa tek lëndët me zgjedhje programi krijon më shumë hapësira për specializim. Kurrikula e programit është e ngjashme deri në një farë mase me programe të tjera kombëtare, çka lehtëson transferimin e studimeve apo punësimin e studentëve. Programi mësimor dhe mësimdhënia zhvillohet në anglisht dhe rrit mundësitë e studentëve për të punuar jo vetëm në tregun vendas, por dhe në atë ndërkombëtar. [Aneks 13. Curricula of the study program]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disave vjetë të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Universiteti Epoka ka një eksperiencë disa vjeçare në fushën akademike, ofron programe në të tre ciklet e studimit dhe ka arritje në fushën e kërkimit shkencor dhe zbatimit të projekteve kërkimore. GVJ konstatoi që PS është hartuar në përputhje me Ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në</p>



	institucionet e arsimit të lartë në RSH" dhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit.		
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Praktika profesionale nuk del si lëndë më vete në planin mësimor sipas VKM 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". [Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabelat 9-10]		
<b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	Programi i studimit "Msc në Ekonomiks" zhvillohet plotësisht në gjuhën angleze. GVJ konstatoi që oferta e UE është shumë e përshtatshme për thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.		
<b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	UE ka një sistem të mirëorganizuar për ruajtjen dhe arkivimin e të gjithë dokumentacionit që lidhet me organizimin dhe realizimin e programit të studimit, të dhënat mbi procesin mësimor, të dhënat mbi stafin akademik, studentët dhe rezultatet e tyre. Aktiviteti është i dokumentuar plotësisht në anglisht dhe në disa aktivitete janë dhe në shqip. [http://dSPACE.epoka.edu.al]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative është një nga Njësitë kryesore që e ka filluar veprimtarinë e vet me hapjen e këtij institucioni në vitin akademik 2008-2009. Fakulteti ka krijuar profilin e tij dhe është konsoliduar gradualisht për t'iu përgjigjur zhvillime kombëtare në përgjithësi dhe atyre në fushën e biznesit në veçanti. PS ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit në bashkëpunim me dy departamentet e tjera të Fakultetit. Departamenti i Ekonomiksit ofron programe në të tre ciklet e studimit.

*Beq* *E. Shela*



	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej <b>37 pedagogë</b>, nga të cilët <b>26 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 3 kanë titullin “Profesorë”, 4 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 9 kanë gradën Dr./PhD, 10 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>11 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 4 kanë gradën Dr./PhD. dhe 5 Asistent Lektorë me Msc. Departamenti i Ekonomiksit ka 8 PAE.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në vitin akademik 2020-2021, sipas evidencës rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie <b>17 pedagogë</b> gjithsej, ku <b>14 janë PAE</b>, nga të cilët 1 Prof.Dr, 4 Prof.Asoc, 9 me gradën Dr/PhD, dhe <b>3 PAK</b> nga të cilët 1 Prof.Asoc dhe 2 me gradën Dr/PhD.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2021-2022 rezulton 4.7/1 ose 82.3% janë PAE dhe me 17.7% PAK.</p> <p>85.7% e ngarkesës në këtë program mbulohet nga PAE. Evidencat e dorëzuara dëshmojnë që mësimdhënia në këtë PS realizohet nga personel akademik i kualifikuar dhe i angazhuar në mësimdhënie në përputhje me gradat dhe titujt akademikë. Në përbërje të stafit ka personel akademik të huaj. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë ka kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme në fushën akademike për të ofruar PS-it.</p> <p><i>[Aneks-Tabelat Permbledhëse, tabela 1 dhe tablea 12.5; Aneks 42. The CVs of the academic staff engaged in the study program]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit "Msc në Ekonomiks" është program studimi i ciklit të dytë, që i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit i përket fushës së shkencave ekonomike, me drejtim specifik në Ekonomiks. GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njësies kryesore, përgjegjëse për programin e studimit (Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative).</p> <p><i>[Aneks 2. The Statute of HEI]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies bazë, përgjegjëse për programin e studimit,</p>	<p>Programi i studimit “Msc në Ekonomiks” ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit, në bashkëpunim me departamente të tjera të Fakultetit. Departamenti ofron vetëm diploma në fushën e Ekonomiksit në të tre ciklet e studimit dhe</p>




<p>sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë synon kualifikimin e stafit të ri me njohuri të përgjithshme vigjilentë ndaj sfidave në ekonomi dhe të aftë për të punuar në administratën publike dhe sektorin privat. GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë (Departamentit të Ekonomiksit), përgjegjës për këtë PS.</p> <p><i>[Aneks 2. The Statute of HEI]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Detyrat dhe përgjegjësitë mbi hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e PS janë të përcaktuara në Statutin e IAL-së. Këto përgjegjësi janë të ndara dhe të harmonizuara midis strukturave organizative, organeve dhe autoriteteve drejtuese (Senatit Akademik, Njësisë kryesore dhe Njësisë bazë). Njësia bazë ka rolin dhe peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e PS. Në rregulloren e PS të ciklit të dytë janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha strukturave përgjegjëse për mbarëvajtjen e PS. GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara më së miri në të gjitha aktet rregullatore të institucionit.</p> <p><i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", Aneks 12. Policy of EPOKA University "On Continuous Improvement of Study Program"; Aneks 2. The Statute of HEI, nenet 16, 26 dhe 54]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Universiteti Epoka ka nënshkruar 98 marrëveshje bashkëpunimi me universitete në rajon, Evropë dhe SHBA, të cilat janë shfrytëzuar për realizimin e objektivave të procesit mësimor, zhvillimin e punës kërkimore shkencore, shkëmbimin e përvojave dhe mobilitetin e studentëve. IAL ka gjithashtu 44 marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, sipërmarrje në</p>

*Autog E Shkolg*



	<p>fusha të ndryshme me qëllim mbështetjen e objektivave të procesit mësimor dhe trajnimit të studentëve. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se Njësia bazë ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë e bashkëpunimit për të realizuar objektivat e përcaktuara për procesin mësimor.</p> <p><i>[Aneks 43. Cooperation agreements and Professional Practice; Shënimet gjatë vizitës]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për realizimin e këtij program studimi nuk ka nevojë për marrëveshje të posaçme.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në takimin me drejtuesit e Njesisë kryesore dhe Njesisë bazë, si dhe nga dokumentacioni, GVJ u informua që institucioni ka marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunon me 44 institucione publike dhe private, një bazë shumë e mirë kjo për realizimin e praktikave të studentëve. Në planin mësimor të PS nuk është parashikuar praktika profesionale.</p> <p><i>[Aneks 43. Cooperation agreements and Professional Practice; Shënimet gjatë vizitës]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>IAL-ja disponon një numër të madh marrëveshjes me Universitete partnere të huaja dhe vendase, si dhe është angazhuar në një numër projektsh me qëllim kërkimin shkencor si dhe mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve. Praktika profesionale nuk është kërkesë e PS, megjithatë institucioni inkurajon çdo student për të marr pjesë në të paktën një veprimtari praktike profesionale gjatë studimeve. Praktika mund të kryehet gjatë periudhës së pushimeve dhe i ndihmon studentët për të praktikuar njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe për tu lidhur me tregun e punës.</p> <p><i>[Aneks 43. Cooperation agreements and Professional Practice; Shënimet gjatë vizitës]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit harton një raport vjetor për çdo vit akademik. Pjesë përbërëse e raportit është dhe analiza e pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit të stafit akademik, si dhe përfitimet nga bashkëpunimi me institucione të tjera në kuadër të projekteve të ndryshme. Raporti hartohet në</p>





	bashkëpunim me Zyrën e kërkimit dhe projekteve, Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Zyrën e Planifikimit të Karrierës.  [Aneks 20. Department Annual Report]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi I.6

**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	UE ka miratuar një rregullore “Mbi promovimin e publikimeve shkencore”, në të cilën janë përcaktuar metodat dhe parimet për nxitjen e stafit akademik të UE për të kryer botime dhe për të marrë pjesë në aktivitete shkencore. Institucioni mbështet financiarisht personelin për të publikuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktorë impakti/të indeksuara dhe për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare. Shpërblimi ndryshon në varësi të numrit të autorëve.  <a href="https://epoka.edu.al/mat/directives/03.pdf">https://epoka.edu.al/mat/directives/03.pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Zyra e Kërkimit dhe Projekteve bashkërendon punën për vlerësimin e rezultateve të punës kërkimore. Punimet shkencore të stafit akademik vlerësohen çdo vit nga një komision i posaçëm pranë Rektoratit (Komisioni për Nxitjen e Botimeve dhe Mbështetjen e Veprimtarive Shkencore) që vlerëson aplikimin dhe merr vendim për të, sipas rregullores “Mbi promovimin e publikimeve shkencore”. Në rregullore jepet në mënyrë të detajuar mënyra e vlerësimit.  <a href="https://epoka.edu.al/mat/directives/03.pdf">https://epoka.edu.al/mat/directives/03.pdf</a>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Puna kërkimore e personelit akademik vlerësohet nga Departamenti dhe më pas pikëzohet nga Rektorati mbështetur tek kjo rregullore. Personeli shpërblehet për veprimtarinë akademike dhe vlera e shpërblimit përcaktohet nga Rektorati. Stafit akademik, sidomos punonjësit e rinj dhe doktorantët, përfitojnë mbështetje financiare për të marrë pjesë në konferenca dhe aktivitete shkencore. Personeli mund të mbështetet për 3 vjet rresht me një fond 700 Euro në vit për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, por ata duhet që të publikojnë punimet e veta. Fondi i alokuar për këtë qëllim në vitin e fundit ka qënë 30 mijë

*Becky G. Shuf*



	Euro. Universiteti nxit botimin e shkrimeve nga stafi akademik veçanërisht në revista shkencore, që indeksohen në Rrjetin e Shkencës Clarivate/Scopus. Personeli akademik nxitet gjithashtu për të publikuar kapituj tekstesh ose libra duke marr mbështetje financiare. Për të promovuar rezultatet e kërkimit UE boton dy revista shkencore: Revista e Kërkimit Social Evropian dhe Revista Ndërkombëtare e Statistikave të Aplikuara dhe Ekonomiksit [ <a href="https://epoka.edu.al/mat/directives/03.pdf">https://epoka.edu.al/mat/directives/03.pdf</a> ; <a href="https://epoka.edu.al/mat/directives/03.pdf">https://epoka.edu.al/mat/directives/03.pdf</a> ; <i>Shënimet gjatë vizitës</i> <a href="https://eco.epoka.edu.al/cat-academic-journal-1811.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=academic-journal&amp;catid=1811&amp;memuid=1811">https://eco.epoka.edu.al/cat-academic-journal-1811.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=academic-journal&amp;catid=1811&amp;memuid=1811</a>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	IAL ka reflektuar politikat e saj për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në udhëzuesin e stafit, i cili i njeh personelit akademik dhe studentëve të drejtën për të pretenduar të drejtën e autorit për veprave të tyre si: libra, artikuj, lëndë mësimore, vepra të ngjashme që synojnë të shpërndajnë rezultatet e kërkime akademike ose studime shkencore. Megjithatë në udhëzues nuk del qartë se cilat janë instrumentat për ta pretenduar këtë të drejtë. [ <a href="https://epoka.edu.al/mat/staff_guide.pdf">https://epoka.edu.al/mat/staff_guide.pdf</a> fq.75-76]		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	UE inkurajon kërkuesit e rinj, kryesisht studentët e ciklit dytë dhe të tretë të përfshihen në kërkimin shkencor, pranë një pedagogu ose në grupe kërkimi pranë departamentit. Studentët mbështeten kryesisht për kryerjen e studimit në terren në lidhje me tezën e tyre, por gjithashtu dhe për të organizuar konferencën studentore çdo dy vjet, ku ata mund të prezantojnë punimet e tyre. Studentët nxiten të publikojnë punimet e tyre, të angazhohen si asistent dhe mbështeten për gjetjen e bursave për doktoraturë jashtë vendit. [ <i>Shënimet gjatë vizitës</i> ]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

*Ant* *E. Shulgj*



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>PS "Msc. në Ekonomiks" është i organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se PS është organizuar në 4 semestra me një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS /në vit, 120 ECTS në total. Plani mësimor është i organizuar në lëndë, ku çdo lëndë vlerësohet me 7.5 ECTS. 1 ECTS është llogaritur me 25 orë. Plani mësimor përbëhet nga 12 lëndë, nga të cilat 6 janë të detyrueshme dhe 6 mund të zgjidhen nga një listë lëndësh, si dhe teza me 30 ECTS.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program; Aneks Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>PS "Msc në Ekonomiks" ka si qëllim kryesor formimin e aftësive teorike dhe teknike në fushën e ekonomiksit për studentët, si dhe aplikimin e këtyre njohurive në praktikë. Referuar përmbajtjes së planit mësimor konstatohet një diversitet lëndësh të drejtimeve të ekonomiksit, financës dhe manaxhimit, por peshën më të madhe e kanë lëndët e ekonomiksit. Lëndët që studentët mund të zgjedhin i shërbejnë profilizimit të tyre kryesisht në fushën e ekonomiksit, por jo vetëm. GVJ është e mendimit se PS i shërben formimit të shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë fushash të ngushta, që natyrisht do të krijonin mundësi më të mëdha punësimi në institucione qëndrore dhe vendore, në institucione rregullatore, sektorin financiar, etj. Programi i studimit me ofrimin e mundësisë për të zgjedhur 6 module nga lista e moduleve me zgjidhje i shërben specializimit, por dhe thellimit të njohurive. Gjithashtu struktura e programit të studimit ofron njohuri të thelluara në fushën e ekonomiksit të aplikuar.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program; Aneks 18.1 Syllabus over year, Aneks 18.2 Syllabus over year; Aneks Tabelat Përmbledhëse]</i></p>

*[Signature]* *[Signature]*



<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ mbasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin që lidhet me këtë program studimi si planin mësimor, syllabuset e lëndëve, Planin Strategjik të Departamentit, si dhe nga informacioni i siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, stafin e programit dhe studentët, është i mendimit se ky program studimi iu ofron studentëve njohuri të thelluara në fushën e “Ekonomiksit”, nxit mendimin kritik mbi teoritë ekonomike dhe zhvillimin e ekonomik, dhe i aftëson studentët për punë kërkimore të pavarur në fushën e ekonomisë.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program; Aneks 14. Diploma Supplement Model, Aneks 18.1 Syllabus over year, Aneks 18.2 Syllabus over year; Aneks Tabelat Përmbledhëse]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Referuar të gjithë dokumentacionit që lidhet me programin e studimit, GVJ konstatoi se PS thellon njohuritë e studentëve në fushën e ekonomiksit, i aftëson ata për të analizuar dhe ndërtuar modele ekonomike për të shpjeguar fenomenet e ndryshme të tregut me të cilat mund të ndeshen kur të futen në tregun e punës apo në studimet e ciklit të tretë.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program; Aneks 14. Diploma Supplement Model, Aneks 18.1 Syllabus over year, Aneks 18.2 Syllabus over year; Aneks Tabelat Përmbledhëse]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ mbas shqyrtimit të elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit Msc në ekonomiks, konstatoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- PS ka të përcaktuara dhe të deklaruara objektivat formuese që synohen të arrihen si dhe kompetencat profesionale që synohet të fitojnë studentët në përmbyllje të studimeve të tyre.</li> <li>- Programi është i organizuar në 4 semestra me një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike, ku çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS me një total prej 120 ECTS;</li> <li>- Plani mësimor përmban 12 lëndë (6 të detyruara dhe 6 me zgjedhje), të cilat zhvillohen të shpërndara në tre semestra (4 lëndë në çdo semestër me 7.5 ECTS secila), ndërsa në semestrin e katërt është punimi i diplomës me 30 ECTS.</li> <li>- Ngarkesa javore është 3 orë/në javë për çdo lëndë. Ngarkesa semestrale në auditor është 48 orë dhe është e njëjtë për të gjitha lëndët.</li> <li>- Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca nr.2). Ato janë</li> </ul>



	<p>organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve, mënyrën e vlerësimit, ngarkesën leksion/seminar dhe ngarkesën e punës së studentit, përmbajtjen e kursit.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program; Aneks 14. Diploma Supplement Model, Aneks 18.1 Syllabus over year, Aneks 18.2 Syllabus over year; Aneks Tabelat Përmbledhëse]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në planin mësimor gjenden të gjitha ndarjet sipas veprimtarive formuese nga A-E dhe modulet e përfshira në secilën kategori. Veprimtaritë formuese janë të përcaktuara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- lëndët bazë (kategoria A) kanë 7.5 ECTS ose 6.25% të krediteve,</li> <li>- lëndët karakterizuese (kategoria B) kanë 60 ECTS, ose 50.0 % të krediteve,</li> <li>- lëndët integruese (kategoria C) kanë 15 ECTS që zënë 12.5% të krediteve,</li> <li>- lëndët plotësuese (kategoria D) kanë 7.5 ECTS ose 6.25% të krediteve,</li> <li>- Kategoria E e detyrimeve përmblylëse përmban 30 ECTS ose 25% të krediteve të PS.</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se përqindja totale e lëndëve të kategorive A plus B është më pak se 60%. Kreditet për detyrimet përmblylëse janë mbi 15% që është kufiri maksimal, ndërsa Lëndët plotësuese në përqindje janë më pak se 10% e krediteve totale. GVJ sugjeron që institucioni duhet të bëjë riorganizimin e veprimtarive formuese sipas kërkesave të VKM 41.</p> <p><i>[Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Programi i studimit ka përcaktuar 30 ECTS për realizimin e diplomës (ose 25% e totalit të krediteve). Në planin mësimor janë përfshirë dhe disa lëndë të detyruara si: Metoda Kërkimi në Ekonomi dhe Financë, Seri Kohore në Ekonometri dhe Lexim dhe Shkrim Akademik, të cilat i aftësojnë studentët për të realizuar punimin e diplomës. Punimi i diplomës është një projekt kërkimor individual, i cili monitorohet nga supervisor të specializuar në fushën përkatëse të temës të studentit. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një udhëzues për mikrotezat për të gjitha ciklet e studimit ku jepen në mënyrë të detajuar udhëzime që</p>

*Ascal* *Shkollë*



	<p>lidhen me përmbajtjen dhe formën që duhet të ketë mikroteza. GVJ konstatoi që kreditet e temës së diplomës nuk janë në përputhje me VKM 41, datë 24.1.2018 "Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". VKM kërkon që tema e diplomës si detyrim përmbyllës të ketë 10-15% të totalit të ECTS.</p> <p>[Aneks 63. Thesis Guideline; Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1]</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ referuar informacionit në sistemin e informacionit të ASCAL, konstatoi se Universiteti Epoka është akredituar për herë të parë si institucion sipas Urdhrit Nr. 260, datë 07.06.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe ka marrë akreditim institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 92, datë 20.10.2017, të Bordit të Akreditimit dhe riakreditimin e fundit me Vendim të BA Nr. 54, datë 16.12.2021.</p> <p>PS Msc në Ekonomiks, është akredituar për herë të parë me Vendim të BA, Nr. 155, datë 16.05.2016.</p> <p><a href="https://ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara">https://ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ka në përbërje tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Ekonomiksit</li> <li>2. Departamenti i Financë – Bankës</li> <li>3. Departamenti i Administrim –Biznesit.</li> </ol> <p>Departamenti i Ekonomiksit ofron 3 programe studimi, një në secilin nga ciklet e studimit. Departamenti i Ekonomiksit bashkëpunon gjithashtu me departamentet e tjera për realizimin e programeve të tyre të studimit të ciklit të parë dhe të dytë.</p> <p>Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për PS "Msc në Ekonomiks", janë të</p>



	<p>përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit në detyrë mban titullin akademik “Profesor Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave”.</p> <p><i>[Aneks 2. The Statute of HEI, neni 11-12]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>FSHEA në vitin e fundit akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij 37 <b>pedagogë gjithsej</b>, ndër të cilët, 26 janë staf akademik efektiv ( PAE) dhe 11 staf akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2021-2022 është si më poshtë:</p> <p><b><u>Departamenti i Ekonomiksit:</u></b> 7 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada</p> <p><b><u>Departamenti i Administrim Biznesit:</u></b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>- 9 PAE, ndër të cilët 5 me tituj / grada; - 8 PAK, ndër të cilët, 6 me tituj / grada;</p> <p><b><u>Departamenti i Financë – Bankës:</u></b></p> <p>- 10 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada; - 3 PAK.</p> <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Ekonomiksit që është përgjegjës për programin e studimit për pesë vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2016-2017, (7 PAE/3 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4/1;</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018, (9 PAE/1 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4/1;</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, (7 PAE/0 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4/0;</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (8 PAE/0 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 5/0;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, (8 PAE/0 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 5/0.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, (7 PAE/0 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 4/0.</p> <p>Përsa më sipër GVJ konstatoi se të tre njësitë bazë, plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik.</p>

*Bertaj* *Shkollë*



	<p>Për sa më sipër Njësia kryesore (FSHEA) dhe Njësia bazë përgjegjëse për programin (Departamenti i Ekonomiksit), përbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik</li> <li>- Organizimin dhe strukturën akademike.</li> </ul> <p>[Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 2.1-2.6]</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>PS nuk ka të parashikuar praktikën në planin mësimor. Megjithatë studentët inkurajohen të bëjnë intership pranë institucioneve ose bizneseve private që iu rekomandohen nga Departamenti ose që i kontaktojnë vet.</p> <p>[Aneks Tabelat Përmbledhëse, tabela 9, Shënimet e vizitës në institucion]</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit kryen dhe funksionin e koodinatorit akademik të PS në rolin e tij si autoriteti drejtues i Njesisë bazë. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit janë përcaktuar në rregulloren e programeve të studimit të ciklit të dytë. Ai komunikon me strukturat e UE, personelin akademik, studentët dhe bashkëpunorët e IAL për realizimin e planit mësimor. Koordinatorin ndjek procesin e studimit në lidhje me strukturën e studimit, orarin e kurseve, datën dhe orën e provimeve, zhvillimin e praktikës dhe ruan të gjithë dokumentacionin përkatës të këtyre proceseve. Departamenti cakton dhe një këshilltar akademik për çdo grup studentësh në çdo vit akademik, i cili miraton regjistrimin e lëndëve që ndjekin studentët në çdo semestër si dhe i mbështet ata në orientimin e karrierës së tyre.</p> <p>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", neni 9]</p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njesisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit, i cili kryen dhe funksionin e koodinatorit akademik të PS raporton në mënyrë periodike në dekanat dhe strukturat e tjera të IAL-së në lidhje me ecurinë e programit të studimit. Të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit janë të arshivuara në departament dhe në Sistemin e Menaxhimit të Mësimimit (LMS) dhe Sistemet Interaktive EPOKA (EIS).</p> <p>[Aneks Shënimet e vizitës në institucion]</p>		
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>

*Beq* *Shelq'*



<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentave të ngarkuara në sistemin e ASCAL dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se FSHEA dhe Departamenti Ekonomiksit, disponojnë informacion të plotë lidhur me PS "Msc në Ekonomiks", siç janë kuotat e pranimit, planin mësimor, informacion mbi strukturën akademike, rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit dhe CV e tyre, etj. Ky informacion është gjithashtu i publikuar në faqen e Departamentit të Ekonomiksit dhe atë të UE.</p> <p><i>[Aneks: 13. Curricula of the study program; Aneks 18.1 Syllabus over year; Aneks 42. The CVs of the academic staff engaged in the study program; Aneks 52. Organizational Scheme of EPOKA University; Aneks 49. Admission quota for all study programs offered at EPOKA University for 2020-2021 academic year, Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs"]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Planit mësimor i PS, "Msc në Ekonomiks", është i organizuar në 12 lëndë dhe tezën e diplomës. Lëndët janë shpërndarë në planin mësimor sipas llojit të veprimtarive (nga A në E). Çdo lëndë vlerësohet me 7.5 ECTS, zhvillohet 3 orë/javë në auditor (ose 48 orë në total) dhe 139.5 orë jashtë auditorit (studim individual). 1 ECTS = 25 orë mësimore. <u>Plani mësimor aktual nuk përmban praktikë mësimore.</u></p> <p><i>GVJ konstatoi që shpërndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese nuk është realizuar sipas kufijëve të përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018. Shuma e ECTS për Veprimtaritë A dhe B së bashku është më e vogël se 60%. GVJ rekomandon që praktika mësimore të bëhet pjesë e planit mësimor në veprimtarinë (Lëndë plotësuese) dhe të grupohen lëndët sipas veprimtarive duke mbajtur në konsideratë kërkesat VKM -së 41, datë 24.01.2018.</i></p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program, Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 9 dhe 10.1]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit</p>	<p>PS "Msc në Ekonomiks" është i organizuar në 4 semestra me një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike. Çdo vit akademik është</p>

*Arta E. Nela*



<p>vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS në secilin vit akademik, në total 120 ECTS. Studentit i ofrohen 8 lëndë gjatë vitit të parë dhe në vitin e dytë akademik 4 lëndë dhe Projekti i Diplomës. <i>GVJ konstatoi që ndarja e lëndëve në semestra dhe vite akademike është në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program; Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 9 dhe 10.1]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit "Msc në Ekonomiks", GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, numrin e provimeve. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm për frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve, etj.</p> <p><i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", Aneks 13. Curricula of the study program, Aneks 18.1 Syllabus over year; Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar kriteret e përgjithshme të pranimit në programet e ciklit të dytë. Ndërsa kriteret specifike si nota mesatare në hyrje dhe kriteret shtesë përcaktohen nga Dekanati mbështetur në propozimin e Departamentit të Ekonomiksit. Në vitin akademik 2020-2021 nota mesatare në hyrje ka qënë 3.23/4. GVJ konstatoi që nota mesatare në hyrje është rritur për gjithë periudhën 2016-2021.</p> <p><i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", neni 13; Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 21]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>PS përbëhet nga 12 lëndë dhe teza e diplomës. GVJ konstatoi që syllabuset e lëndëve janë në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 dhe ofrojnë informacionin e nevojshëm për studentët. Ato janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat e lëndës, konceptet bazë që do trajtohen, temat që do të zhvillohen çdo javë, literaturën bazë dhe literaturën ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve, ngarkesën javore, detyrimet lëndore dhe format e vlerësimit.</p> <p><i>[Aneks 18.1 Syllabus over year]</i></p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>IAL ka politika të miratuara për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Ndryshimet propozohen nga Departamenti dhe dërgohen në dekanat. Nëse Dekanati është dakort procedura vazhdon në Komisionin e Kurrikulave, i cili e dërgon për mendim dhe në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. GVJ konstatoi se nga akreditimi i parë deri në riakreditim (2016-2017) programi ka patur ndryshime me 18 ECTS ose 15%. Ndryshimet e planit mësimor, të syllabuseve, të literaturës, janë në zbatim të ndryshimit të bazës ligjore. Ndryshimet bëhen përpara fillimit të vitit akaemik</p> <p><i>[Aneks 12. Policy of EPOKA University "On Continuous Improvement of Study Program", Aneks-Tabelat Përmbledhëse fq.18, Shënimet e vizitës në institucion]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi II.4</b></p>	
<p><b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit "Master i Shkencave"/"Master i Arteve" është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton që kohëzgjatja e studimeve (2 vite akademike ose 120 ECTS), numri i orëve për kredit (1 ECTS = 25 orë), ngarkesa javore në auditor dhe jashtë auditorit, sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh (60 ECTS) ose 1500 orë mësimore pune të studentit janë në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018.</p> <p><i>[Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>PS "Msc në Ekonomiks" iu ofron studentëve njohuri të thelluara dhe të aplikuara në fushën e ekonomisë. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve të reja dhe të thelluara, zhvillimin e afësive dhe kompetencave të parashikuara në objektivat e programit. Ndarja e orëve në auditor dhe jashtë auditorit i jep përparësi punës individuale të studentëve. GVJ duke iu refruar përmbajtjes së PS, emërtesës së lëndëve dhe syllabuseve të lëndëve mendon që PS mundëson marrjen e njohurive të reja dhe të thelluara, dhe aftëson studentët për tu future në tregun e punës.</p>



	<p><i>Pavarësisht për sa më sipër GVJ i rekomandon institucionit të rishikoj planin mësimor për të përfshirë praktikën mësimore dhe për të bërë shpërndarjen e lëndëve në veprimtari mësimore sipas kërkesave të VKM nr. 41, datë 24.01.2018.</i></p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program, Aneks 18.1 Syllabus over year Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët e programit të studimit janë shpërndarë në mënyrë të tillë që sigurojnë një shpërndarje të njëjtë të ngarkesës në të dy vitet akademike. GVJ është i mendimit se shpërndarja e lëndëve dhe krediteve mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe arritjen rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Shpërndarja e ngarkesës është e njëjtë mes semestrave të ndryshëm, dhe viteve të ndryshme duke i dhënë një ngarkesë të njëjtë studentëve. Shpërndarja e lëndëve, është e tillë që në vitin e parë mundëson kryesisht marrjen e njohurive bazë dhe formuese, ndërsa në vitin e dytë realizohet thellim dhe profilizim në disiplinat karakterizuese dhe ato me zgjedhje të programit, duke krijuar edhe mundësinë e thellimit dhe diversifikimit të njohurive.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program, Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit përbëhet nga 12 lëndë, secila me nga 7.5 ECTS. 6 lëndë janë të specifikuara në plan, ndërsa 6 lëndët e tjera mund të zgjidhen nga lista e moduleve me zgjedhje. Fondi i lëndëve karakterizuese që mund të zgjidhen është i madh në numër dhe lejon specializim kryesisht në fushën e ekonomisë dhe/ose biznesit. Duke iu referuar edhe informacionit të siguruar në institucion nga drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, shpërndarja lëndore, numri i lëndëve, kreditet e çdo lënde, rezultojnë të ngjajshëm me programe të përafërta të universiteteve amerikane.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program, Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1, Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përqindja e lëndëve sipas veprimtarive formuese nuk është sipas përqindjeve të parashikura në VKM 41, datë 24.01.2018. Disa nga problematikat janë: Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B është më e vogël se 60%, detyrimet përmbyllëse janë më të mëdha se 20% (25%) dhe lëndët ploësuese zënë më pak se 10%. Departamenti Ekonomikist</p>





	<p>duhet të bëj riorganizimin e lëndëve duke mbajtur parasysh këtë VKM. Në planin mësimor ka lëndë të cilat kanë qasje praktike. Lëndët e përfshira në planin mësimor mundësojnë arritjen e objektivave formuese, megjithatë kjo shpërndarje mund të krijojë probleme në transferimin e studimeve. Organizimi i mësimit bëhet sipas sistemit leksione dhe seminare së bashku.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program, Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 9]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>UE ka miratuar procedurën për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Referuar dokumentacionit dhe takimeve me stafin akademik, rezultojnë se syllabuset përditësohen vazhdimisht, si detyrim ndaj kërkesave ligjore por edhe si rezultat i përditësimit të literaturës. UE përdor materiale mësimore në gjuhën angleze për këtë program studimi dhe literatura e detyruar dhe ndihmëse rezultojnë e përditësuar, por kushti i 5 viteve të fundit nuk mund të realizohet për çdo lëndë.</p> <p><i>[Aneks 12. Policy of EPOKA University "On Continuous Improvement of Study Program", Aneks 18.1 Syllabus over year, Shënime të vizitës në institucion ]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Plani mësimor përmban mjaft lëndë të cilat mundësojnë marrjen e njohurive të thelluara në fushën e ekonomisë si: Mikroekonomi dhe Makroekonomi e aplikuar, Metodatat e Kërkimit në Ekonomiks, Politika Monetare, Financa Ndërkombëtare, etj., duke bërë të mundur që përmbajtja e programit të garantojë përfitimin e dijeve të reja, aftësimin e studentëve për t'i përdorur këto njohuri në praktikë dhe për të arritur kompetencat e synuara për këtë program studimi. Plani mësimor me numrin e madh të lëndëve që studentët mund të zgjedhin garanton përfitimin e dijeve në disa fusha që mund të ndërthuren me njëra tjetrën si ekonomiks dhe financë, apo ekonomiks dhe biznes.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program, Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1, Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Mundësia për të marrë 6 lëndë të ndryshme me zgjedhje nga 12 lëndë që përmban programi i studimit, iu krijon studentëve mundësi për të zgjedhur lëndë që iu vlejshëm për studime të mëtejshme në ciklin e tretë me drejtimin ekonomiks, por edhe në drejtimeve të tjera të përafërta. Gjithashtu kjo ofertë iu mundëson studentëve që të marrin njohuri në fusha për të cilat ka nevojë tregu i punës. Pra programi i studimit mundëson si</p>



	<p>vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë ashtu dhe daljen në tregun e punës në profile që janë të kërkuara.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program, Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1, Shënime të vizitës në institucion]</i></p>		
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>UE tërheq mendimin e kompanive përmes një pyetësoari, i cili ka për qëllim të vlerësoj performancën e studentëve të punësuar në këto kompani. Pyetësoari menaxhohet nga Zyra e Karrierës dhe Studentëve të diplomuar dhe mendimet e punëdhënësve shërbejnë për të përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit. Ky është një instrument shumë i përshtatshëm për të kuptuar më mirë kërkesat e tregut të punës si dhe për të adresuar në të ardhmen ndryshime në planin mësimor në përputhje me kërkesat e tregut të punës</p> <p><i>[Aneks 51. Company Satisfaction Survey]</i></p>		
<p><b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Oferta akademike e programit të studimit iu mundëson studentëve që të marrin njohuri në fusha për të cilat ka nevojë tregu i punës. Në planin mësimor janë përfshirë gjithashtu disa module si: Seritë kohore, Ekonomia matematikore, Metodatat e Kërkimit në Ekonomi dhe Financë dhe disa module me njohuri të thelluara në fushën e ekonomiksit që iu mundësojnë studentëve si vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë dhe/ose të dalin në tregun e punës në profile që janë të kërkuara në sektorin bankar apo tregun e sigurimeve. Pjesa më e madhe e studentëve në këtë program studimi synonin studimet e ciklit të tretë.</p> <p><i>[Aneks 13. Curricula of the study program, Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10.1, Shënime të vizitës në institucion]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që</p>	

*Arben E. Shkollaj*




<p>angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar tabelave pëmbledhëse [Aneks-Tabelat Pëmbledhëse, Tabelat 6.1, 6.2, 6.3, 6.4, 6.5 dhe 6.6], të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë gjashtë viteve akademike janë si më poshtë:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Për vitin akademik <b>2021-2022</b> janë të angazhuar <b>10</b> pedagogë ndër të cilët <b>6 PAE</b> dhe <b>4 PAK</b>. Mbulimi i programit në përqindje është <b>80.0% PAE dhe 20.0% PAK</b>.</p> <p>Për vitin akademik <b>2020-2021</b> janë të angazhuar <b>14</b> pedagogë ndër të cilët <b>11 PAE</b> dhe <b>3 PAK</b>. Mbulimi i programit në përqindje është <b>85.7% PAE dhe 14.3% PAK</b>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Për vitin akademik <b>2019-2020</b> janë të angazhuar <b>17</b> pedagogë ndër të cilët <b>13 PAE</b> dhe <b>4 PAK</b>. Mbulimi i programit në përqindje është <b>81.8% PAE dhe 18.2% PAK</b>.</p> <p>Për vitin akademik <b>2018-2019</b> janë të angazhuar <b>16</b> pedagogë ndër të cilët <b>13 PAE</b> dhe <b>3 PAK</b>. Mbulimi i programit në përqindje është <b>80.0% PAE dhe 20.0% PAK</b>.</p> <p>Për vitin akademik <b>2017-2018</b> janë të angazhuar <b>14</b> pedagogë ndër të cilët <b>13 PAE</b> dhe <b>1 PAK</b>. Mbulimi i programit në përqindje është <b>95.5% PAE dhe 4.5% PAK</b>.</p> <p>Për vitin akademik <b>2016-2017</b> janë të angazhuar <b>14</b> pedagogë ndër të cilët <b>8 PAE</b> dhe <b>6 PAK</b>. Mbulimi i programit në përqindje është <b>69.6% PAE dhe 30.4% PAK</b>.</p> <p>Për sa i përket kualifikimeve të PA:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për 2016-2017, 85.7% e personelit akademik kanë gradë shkencore/tituj akademik, 14.3% janë Msc;</li> <li>- Për pesë vite akademike duke filluar nga viti akademik 2017-2018, 100.0% e personelit akademik kanë qënë me grada shkencore/tituj akademik.</li> </ul> <p>[Aneks-Tabelat Pëmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3, 12.4, 12.5 dhe 12.6]</p> <p>Referuar dokumentacionit të konsultuar më sipër si dhe CV-ve të stafit akademik dhe programit mësimor, GVJ konstatoi se për të pesë vitet e fundit akademike, 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022 programi i studimit:</p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përmbush kërkesën ligjore që personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi (VKM 418, Maj 2017).</li> <li>- përmbush kërkesën ligjore të të pasurit së paku kualifikimin e një cikli pasardhës për të gjithë stafin akademik që mbulon programin e studimit;</li> <li>- niveli i kualifikimit, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</li> </ul> <p><i>[Aneks 42. The CVs of the academic staff engaged in the study program; Aneks-Tabelat Përmbledhëse]</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Praktika profesionale nuk është përfshirë në këtë program studimi. Megjithatë studentët inkurajohen që të kryejnë intershipe në institucione/biznese të ndryshme.</p> <p>Departamenti i Ekonomiksit ka angazhuar personelin e duhur për instruktimin dhe udhëheqjen e studentëve për punimin e diplomës. Personeli akademik organizon takime individuale me studentët, i orientojnë ata për tematikën e punimit të diplomës, strukturën e punimit, metodologjinë, rishikimin e literaturës dhe shmangien e plagjaturës në punim etj.</p> <p><i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs"; Aneks 20. Department Annual Report, fq.50, Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në institucion dhe takimi me studentët dhe personelin akademik, se përveç personelit akademik, në ndihmë të procesit mësimor, departamenti angazhon edhe staf ndihmës akademik, të cilët asistojnë stafin akademik gjatë procesit mësimor. Për këtë program studimi përdoren laboratorët e informatikës të cilat përdoren dhe nga studentë të programeve të tjera. <i>[Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="width: 25%;"></th> <th style="width: 25%;">Përmbushet pjesërisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet kryesisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="font-size: 1.5em;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**Standardi II.6**





**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>UE ka miratuar një procedurë për përmirësimin e programeve të studimit. Sipas kësaj procedure përmirësimi i programit të studimit mund të ndodhë ndër të tjera dhe për nevoja të tregut të punës, të sipërmarrjeve dhe bashkëpunëtorëve të institucionit. Për të realizuar këtë institucioni përdor anketën e kënaqshmërisë së kompanive. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoj që IAL e ka përdorur këtë instrument, megjithatë nuk u identifikua ndonjë rast kur programi mësimor të ishte ndryshuar mbështetur në këto propozime.</p> <p><i>[Aneks 12. Policy of EPOKA University "On Continuous Improvement of Study Program", Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>UE inkurajon dhe studentët për tu përfshirë në përmirësimin e programeve të studimit. Përmirësimi i programit të studimit mund të ndodhë ndër të tjera dhe për nevoja të studentëve. IAL për të mundësuar përfshirjen e studentëve përdor pyetësorin me studentët dhe të diplomuarit, etj. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi që IAL e ka përdorur këtë instrument. Gjetjet e pyetësorit i vihen në dispozicion Departamentit, i cili identifikon nevojat për përmirësime dhe reflekton propozimet e tyre në programin e studimit.</p> <p><i>[Aneks 12. Policy of EPOKA University "On Continuous Improvement of Study Program", Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka një bazë të dhënash për studentët e diplomuar, të cilën e përditëson në mënyrë periodike. UE mban kontakte me të diplomuarit dhe tërheq mendimet e tyre përmes një pyetësoi të dedikuar për ta (anketa e të diplomuarëve). Kontakte të vazhdueshme mbahen nga Zyra e Karrierës dhe të Diplomuarëve. Në pyetësorin e realizuar në vitin akademik 2019-2020 janë të përfshirë dhe studentët e këtij PS dhe në të ka shumë sugjerime për përmirësimin e programeve të studimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që propozimet që merren nga të diplomuarit kanë shërbyer për përmirësimin e programeve të studimit.</p> <p><i>[Aneks 16. Alumni Survey, fq.18-22; Aneks 17. Update Alumni Records; 23 Alumni Survey Form;]</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>IAL ka të miratuara të gjitha procedurat që i mundësojnë përshtatjen dhe riorganizimin e programeve të studimit dhe në fusha specifike studimi dhe kërkimi. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ nuk identifikoj ndonjë program që të ishte përshtatur apo riorganizuar sipas këtij kriteri.</p> <p><i>[Aneks 12. Policy of EPOKA University "On Continuous Improvement of Study Program"]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p><b>Standardi II.7</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit "Msc në Ekonomiks" synon aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të zbatuar parimet ekonomike. Objektivat kryesorë të PS janë klasifikuar në tre dimensione dhe ato ndërthuren më së miri me objektivat e institucionit në fushën e mësimdhënies, kërkimit dhe shërbimeve për komunitetin.</p> <p><i>[Aneks 14. Diploma Supplement Model; Aneks 3. Institution Development Strategy fq. 12-13; Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", neni 5]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Njësia bazë dhe ajo kryesore janë përgjegjëse për administrimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë mësimdhënëse dhe kërkimore për këtë program studimi. Departamenti ka krijuar Komitetin Shkencor, i përbërë nga 3 antarë me grada që ka përgjegjësinë për zhvillimin e strategjisë së programit, planit mësimor, programit të kërkimit dhe hartimin e kriterëve për pranimin e studentëve në ciklin e dytë. Në veprimtarinë e tij Komiteti mbështetet dhe nga Koordinatori i Programit, detyrat specifike të të cilit janë përfshirë në rregulloren e programeve të studimit të ciklit të dytë. GVJ konstatoi mbështetur në dokumentacion dhe në takimet me stafin akademik që institucioni respekton lirinë akademike të stafit në fushën e mësimdhënies dhe mbështet veprimtarinë e tyre kërkimore.</p> <p><i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", neni 7, neni 9]</i></p>

*[Handwritten signatures]*



<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Kërkimi shkencor është një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Departamentit të Ekonomiksit. PS "Msc në Ekonomiks" iu mundëson studentëve angazhim në punë të mirëfilltë kërkimore. Departamenti e ka nxitur veprimtarinë kërkimore të përbashkët të pedagogëve me studentët. Studentët janë mbështetur gjithashtu një herë në dy vjet për realizimin e konferencave ku kanë mundësi që të prezantojnë dhe arrijtjet e punës së tyre.</p> <p><i>[Shënimet e vizitës në institucion]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit ofron njohuri të cilat janë të lidhura ngushtësisht me politikat kombëtare dhe rajonale. Lëndë të tilla si: Sistemi Bankar Shqiptar dhe Banka Qëndrore, Ekonomia Shqiptare I dhe II), Integrimi Ekonomik dhe BE fokusohen në zbatimin e politikave kombëtare dhe rajonale. Njësia bazë ka orientuar gjithashtu punimet e diplomës në fusha me interes kombëtar dhe rajonal p.sh Ndikimi i politikës monetare në rritjen ekonomike në vendet e Europës Qëndrore, Lindore dhe Juglindore, Covid 19 dhe ndikimi në biznesin shqiptar, etj.</p> <p><i>[Aneks 20. Department Annual Report]</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>UE ka miratuar procedura që rregullojnë dhe mbështesin financimin e punës kërkimore deri në nivelin e Njesisë bazë. Buxheti për kërkimin shkencor mbulon projektet e fakulteteve dhe qendrave kërkimore, pjesëmarrjet në konferenca ndërkombëtare, publikimet e artikujve në revista shkencore me faktorë impakti, si dhe të rankuara në Scopus/Thomson Reuters, publikimet e artikujve në revista të tjera ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe shpenzime për bashkëfinancim dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore rajonale dhe ndërkombëtare. Miratimi i fondeve bëhet nga një komision i ngritur nga Rektorati. Në takimet me personelin akademik GVJ konstatoi që institucioni ka mbështetur financiarisht stafin e Departamentit të Ekonomiksit për publikim artikujsh, pjesëmarrje në konferenca, shkrimin e kapitujve në tekste si dhe pjesëmarrjen në projekte,</p> <p><i>[Aneks 66. Epoka University Regulation-On Scientific Research, neni 17; Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.8**



**Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>UE ka miratuar një rregullore për kërkimin shkencor. Në këtë procedurë është përcaktuar që stafi inkurajohet të bëjë punë kërkimore dhe veprimtaria e tij shkencore vlerësohet çdo vit. UE angazhohet përmes kësaj rregullore që të mbështes dhe asistoj stafin akademik në kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare IAL ka miratuar gjithashtu një udhëzim për mënyrën se si duhet të realizohen propozimet për projekte kërkimore nga stafi. Personeli akademik me kohë të plotë përfiton mbështetje financiare nëse publikon në revista ndërkombëtare me faktor impakti dhe të rankuara në Scopus. Mbështetja financiare që jepet për artikuj është 750 Euro në varësi të faktorit të impaktit, ndërsa për të marr pjesë në konferenca ndërkombëtare mund të financohet deri në 1500 Euro. Për stafin që publikon libra apo kapituj librash jepet një mbështetje 500 deri në 1000 Euro. Fondi në dispozicion për vitin 2021 ka qënë 30 mijë Euro. UE mbështet gjithashtu dhe organizimin e konferencave të studentëve në çdo dy vjet si dhe krijon hapësira për punime të përbashkëta personel akademik-studentë.</p> <p><i>[Aneks 66. Epoka University Regulation -On Scientific Research; Aneks 67. Common Guidelines for Scientific Research Proposal Submission; Aneks 65. RPO data - Projects list on which staff is involved, Shënime nga vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit është angazhuar në punë kërkimore mbështetur në strategjinë e kërkimit të institucionit. Në këtë departament zhvillojnë aktivitetin kërkimor 5 grupe të cilat kanë publikuar në 5 revista shkencore ndërkombëtare. Departamenti është përfshirë gjithashtu në zbatimin e tre projekteve në nivel departamenti si partner të financuara nga Programi i Këmbimeve të Europës Qëndrore për Studimet Universitare (CEPUS).</p> <p><i>[Aneks 20. Department Annual Report, fq.44-48]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit ka organizuar dhe konferenca shkencore, përmes të cilave mbështetet personeli akademik dhe studentët për të arritur objektivat e tyre në fushën e kërkimit. Universiteti Epoka, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatën Ekonomike të Shqipërisë, kanë organizuar Konferencën e 2-të Ndërkombëtare</p>



	për Statistikat e Aplikuara dhe Ekonometrinë në Maj 2019 (ICASE 2019). [ <a href="https://icase.epoka.edu.al/2019/">https://icase.epoka.edu.al/2019/</a> ]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Siç specifikohet në “Kornizën e Strategjisë 2018-2022 të Universitetit EPOKA” si dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në strategjinë e institucionit, janë përcaktuar si qëllime prioritare përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies, trajnimi i stafit dhe pjesëmarrja e tij në të mësuarin afatgjatë. Bazuar në dokumentat e vendosura në dispozicion dhe në vizitën në institucion, GVJ vuri re se institucioni zhvillon trajnime të vazhdueshme për të përmbushur këtë qëllim. [Aneks 3. Institution Development Strategy; Aneks 32. Example of Documents on Training Events for Standart III.4 criteria 4&5]
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Institucioni vlerëson në mënyrë periodike performancën e stafit, përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve, si dhe pajisjen e studentëve me aftësi që kërkohen nga tregu i punës. GVJ konstaton se institucioni aplikon forma të diversifikuara të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike, të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Monitorimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga përgjegjësi i departamentit si dhe nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Gjithashtu studentët çdo fund semestri plotësojnë nëpërmjet sistemit EIS,

*Arta E. Shkëlq*



	<p>pyetësorin për çdo lëndë/pedagog, i cili përmban edhe pyetje për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse.</p> <p><i>[Aneks 22. Student Satisfaction Survey; Aneks 21. Course Instructor Evaluation Survey; Aneks 62. Teaching Evaluation Form]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në fund të çdo semestri, studentët plotësojnë online pyetësorët që mbledhin informacion mbi format e mësimdhënies, performancën e pedagogëve, përmbajtjen e lëndëve, relevancën dhe burimet e ndryshme të literaturës, si dhe lejon ata që të vlerësojnë objektivist duke ruajtur anonimat e përgjigjeve. Studentët i bëjnë këto vlerësime para se të marrin notën përfundimtare të lëndës, për të siguruar kështu numër të lartë përgjigjesh dhe paanshmëri në varësi të vlerësimit të tyre në lëndën për të cilën japin vlerësimin. Studentët kanë gjithashtu të drejtën dhe mundësinë të paraqesin ankesat apo problemet që hasin përgjatë studimeve tek Dekani i studentëve.</p> <p><i>[<a href="http://ams.asc.al/ams/components/dokumentat/proceduravie.php?id=78356">http://ams.asc.al/ams/components/dokumentat/proceduravie.php?id=78356</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton që rezultatet e vlerësimeve bëhen publike në faqen e internetit. Ka një politikë të Universitetit Epoka “Për vlerësimin e vazhdueshëm të Programit të studimit</p> <p>Megjithatë, raportet vjetore të Departamentit të Ekonomiksit, nuk përmbajnë një seksion mbi rezultatet e vlerësimit dhe as është e qartë apo e specifikuar mënyra/mekanizmi se si përdoren këto rezultate për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.</p> <p><i>[Aneks 12. Policy of EPOKA University “On Continuous Improvement of Study Program”; Aneks 20. Department Annual Report]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Në baza vjetore, bëhet anketimi i ish-studentëve, dhe në bazë të rezultateve, departamenti vendos nëse është nevoja të modifikohen rezultatet dhe objektivat dhe drafton ndryshimet. Anketimet me studentët aktualë që kryhen në fund të çdo semestri si për të vlerësuar instruktorët, kursin, dhe ato të kënaqësisë së studentëve, përdoren për të identifikuar problemet dhe nevojat. Pedagogët me vlerësimin më të ulët komunikojnë me dekanin për problematikat e identifikuara. Jepen rekomandime se si mund të përmiresohen programet, mënyra dhe cilësia e mësimdhënies, dhe këto ndahen edhe me studentet. Stafi trajnohet çdo fillim semestri në lidhje me teknikat e mësimdhënies, si dhe praktika të tjera me interes për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.</p> <p><i>[Aneks 21. Course Instructor Evaluation Survey; Aneks 22. Student Satisfaction Survey; 23. Alumni Survey Form]</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit			
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimet me pedagogët dhe studentët, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstatoi se në kurrikulën e programit të studimit Master Shkencor në Ekonomi dhe në syllabuset e lëndëve (shtojca nr. 18.1 “Syllabus i vitit akademik 2021-2022”)</p> <p>është planifikuar zhvillimi i procesit mësimor dhe metodave të mësimdhënies sipas të cilit procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, punë laboratorike, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime të përgjithshme përfundimtare, praktika profesionale, punim diplome, projekte etj. Në këtë aspekt mund të themi që institucioni përdor metoda të ndryshme dhe inovative në procesin e mësimdhënies.</p> <p><i>[Aneks 18.1 Syllabus over year]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>GVJ u informua në takimet me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi se personeli akademik është i gatshëm t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve duke ofruar forma e metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies përsa lejon fusha dhe natyra e programit.</p> <p>Trajnimet dhe aktivitetet jashtë kurrikulare janë dy prej metodave alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies që universiteti Epoka ofron në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit. Studentët shprehen tepër pozitiv në lidhje me këto aktivitete formuese, duke thënë se janë një mundësi e mirë për të lidhur pjesën praktike me teorinë. I gjithë informacioni mbi modulet e trajnimeve dhe aktiviteteve alternative të mësimdhënies bëhet publik dhe gjendet në faqen e web-it të Universitetit Epoka.</p> <p><i>[<a href="https://eco.epoka.edu.al/">https://eco.epoka.edu.al/</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet,</p>	<p>Institucioni ka një politikë të qartë të specifikuar në “Kornizën e Strategjisë 2018-2022 të Universitetit EPOKA” për mbështetjen e personelit të tij akademik në përmirësimin e vazhdueshëm në procesin e mësimdhënies. Për të përmbushur këtë objektiv institucioni zhvillon trajnime për përmirësimin e aftësive të personelit akademik. Në bazë të dokumentacionit, ku përcaktohen</p>



objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	<p>trajnimet dhe objektivat formues, GVJ vlerëson se universiteti Epoka kryen në vazhdimësi trajnimin e personelit akademik duke mundësuar në këtë mënyrë staf akademik të kualifikuar dhe të përditësuar me metodat inovative dhe fleksible pedagogjike.</p> <p><i>[Aneks 39. List of Training Activities for Staff]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të “CV-të e personelit akademik” GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është kompetent në shpjegimin e njohurive që duhet të ofrojë programi. Gjithashtu gjatë bisedave me studentët dhe drejtuesit GVJ u informua që pedagogët përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies në varësi të tematikave apo profilit të vetë lëndës.</p> <p>Gjatë takimit me zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ u informua që institucioni i jep një rëndësi të madhe kriterëve që aplikon në rekrutimin e personelit akademik. Sipas Rregullores së Universitetit Epoka “Për rekrutimin e stafit” disa nga kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidatëve janë ato që lidhen me tregues të performancës së kandidatëve, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar, si dhe karriera profesionale jashtë auditorit;</li> <li>• Artikuj dhe publikime në revista shkencore dhe profesionale, projekte kërkimore të mbështetura nga institucione ndërkombëtare dhe kombëtare;</li> <li>• Paraqitja gjatë leksionit demo/të hapur para Departamentit përkatës.</li> </ul> <p><i>[Aneks 42. The CVs of the academic staff engaged in the study program; Aneks 11. Regulation of EPOKA University “On Staff Recruitment”]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion, GVJ vlerëson se institucioni përdor vlerësimin periodik të procesit mësimor me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë procesit të vlerësimit marrin pjesë jo vetëm drejtuesit e institucionit dhe të departamentit, por edhe studentët. Studentët kryejnë vlerësim në fund të çdo semestri përmes sistemit të komunikimit elektronik EIS përpara se të njihen me vlerësimin përfundimtar të lëndës. Problematikat e evidentuara adresohen gjatë takimeve të departamentit dhe/ose trajnimeve vjetore të organizuara nga institucioni. Përveç pyetësorëve të vlerësimit studentët shprehin opinionet e mendimet e tyre në lidhje me procesin mësimor dhe i</p>



	<p>diskutojnë së bashku me lektorin ku më pas merren masa për të reflektuar ndryshimet e nevojshme.</p> <p><i>[Aneks 21. Course Instructor Evaluation Survey; Aneks 62. Teaching Evaluation Form; Shënime të vizitës në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Duke u bazuar në syllabuset e lëndëve të programit të ciklit të dytë të studimeve në Ekonomi GVJ vlerëson se personeli akademik parashikon zhvillimin e orëve mësimore nëpërmjet metoda bashkëvepruese për të inkurajuar përfshirjen dhe mësimnxënien e studentëve. Studentët nxiten të jenë të përditësuar me informacionet dhe debatet ekonomike aktuale sipas tematikave dhe profileve të lëndëve përkatëse në mënyrë që të zhvillohen debate dhe të ndajnë opinionet e tyre. Këto metoda përfshijnë debate, punë në grup dhe prezantime të punimeve të studentëve të cilat vlerësohen me pikë sipas peshave përkatëse gjatë vitit akademik.</p> <p><i>[Aneks 18.1 Syllabus over year]</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Në varësi të tematikës dhe profilit të çdo lënde që ofrohet në program, sipas "Syllabusi të vitit akademik 2021-2022", studentët angazhohen në punë të pavarura si p.sh projekte dhe detyra kursi për të zhvilluar mendimin kritik dhe për të vlerësuar performancën akademike. Në të njëjtën kohë studentët kanë mundësi të marrin këshillim dhe mbështetje nga pedagogët e caktuar nga departamenti për secilën prej klasave dhe jo vetëm. Këshillimi përfshin një spektër të gjerë aktiviteteve të cilat ndihmojnë në vendosjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve profesionale të shëndetshme.</p> <p><i>[Aneks 18.1 Syllabus over year]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				<b>X</b>

<p><b>Standardi III.3</b>  <b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësimnxënien dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Në shtojcën e Tabelave përmbledhëse përcaktohet qartësisht e gjithë infrastruktura e vendosur nga institucioni në shërbim të zhvillimit të orëve mësimore dhe aktiviteteve mbështetëse për studentët që ndjekin programin Master Shkencor në Ekonomiks. Gjatë vizitës në universitet, GJV pati mundësinë të shikonte dhe verifikonte hapësirat</p>

*[Signature]*



	<p>në fjalë dhe vlerëson se përmbushin cilësinë e duhur dhe kushtet e mirëmbajtjes.</p> <p><i>[Aneks Tabelat Përmbledhëse, tabela 16]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Hapësirat universitare janë të pajisura me bazën materiale të nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor dhe aktivitete të tjera mbështetëse. Klasat mësimore janë të pajisura me PC dhe videoprojektorë. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Vlerësimi i GVJ në shtojcën mbi infrastrukturën në funksion të programit të studimi ku specifikohen hapësirat dhe baza materiale e vendosur në funksion të studentëve dhe në vizitën fizike në universitet.</p> <p><i>[Aneks 45. Infrastructure in function of the study program; Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, in frastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Laboratorët e informatikës mbështesin zhvillimin e pjesës praktike të programit mësimor nëpërmjet logjistikës dhe software-ve bashkëkohorë dhe të përditësuar nga Zyra e Koordinimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ZKTIK) në mënyrë që t’i shërbejnë sa më mirë procesit mësimor. Sipas shtojcës mbi infrastrukturën në funksion të programit të studimi sistemet operative të përdorura përfshijnë programet dhe shërbimet më inovative për studentët dhe stafin akademik në të njëjtën kohë. Ndër sistemet më të përdorura nga të dyja palët është Sistemi Interaktiv Epoka (EIS) i cili organizon në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe digjitale nevojat dhe detyrat e komunitetit universitar. Në këtë sistem, studentët marrin pjesën më të madhe të informacionit lidhur me procesin mësimor (kurrikulat, syllabuset, oraret etj) dhe njoftohen për vlerësimet individuale përgjatë gjithë vitit akademik.</p> <p><i>[Aneks 45. Infrastructure in function of the study program; Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Universiteti siguron përveç literaturës bazë edhe literaturën dytësore/ndihmëse për secilën prej lëndëve të ofruara në mënyrë që studentët të njihen në gjerësi me konceptet dhe njohuritë e nevojshme që parashikon programi. E gjithë literatura e rekomanduar mund të gjendet në bibliotekën e universitetit dhe mund të aksesohet nga studentët sipas rregullave të universitetit. Përtej bibliotekës fizike, sipas shtojcës “Infrastruktura në funksion të programit të studimit”, universiteti ofron dhe databazën digjitale duke ofruar aksese në një prej librarive digjitale më të përdorura nga profesionistët akademikë (JSTOR).</p>



	<i>[Aneks 45. Infrastructure in function of the study program; Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka e institucionit ka një kapacitet të mjaftueshëm prej 100 vendesh studimi dhe siguron hapësirë të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët dhe stafi akademik. Libraria ka një volum të librave të printuar prej 25000. Në shtojcën “Lista e librave/botimeve periodike në bibliotekë” përcaktohen të detajuar sipas titullit të gjithë librat (të printuar dhe elektronikë) që biblioteka zotëron por nuk përcaktohet vitit i botimit. Në këtë aspekt është e vështirë të përcaktohen prurjet e reja dhe më të fundit. <i>[Aneks 26. List of books or periodicals in the Library; Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Stafi akademik dhe studentët kanë të drejtën e antarësimit dhe shkarkimit të materialeve të nevojshme në një prej librarive digjitale me të përdorura akademike në përputhje me fushën e programit të studimit të ciklit të dytë në Ekonomiks dhe jo vetëm. JSTOR përfshin rreth 2000 revista akademike dhe mund të aksesohet në faqen e web-it të universitetit Epoka. Në këtë aspekt, GVJ vlerëson se universisteti Epoka ofron për studentët e saj aksesim digjital të literaturës në përputhje me programin e studimit. <i>[Aneks 26. List of books or periodicals in the Library; Shënime të vizitës në institucion; Aneks 45. Infrastructure in function of the study program]</i>
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Në shtojcën “Infrastruktura në funksion të programit të studimit” përcaktohet se universiteti ofron 4 laboratorë me një total prej 128 PC për përdorim të studentëve në funksion të përmbushjes së kurrikulave mësimore të programit të studimit të ciklit të dytë në Ekonomiks. Përtej bazës materiale, laboratorët janë të pajisur me lidhje në rrjet dhe sistemet e nevojshme operative dhe aplikative në bazë të specifikive të lëndëve përkatëse. Studentët, gjatë takimit fizik, shprehen se infrastruktura e përmendur më sipër është lehtësisht dhe gjerësisht e përdorur në përputhje me objektivat e lëndëve të programit të ciklit të dytë të studimit në Ekonomiks. <i>[Aneks 45. Infrastructure in function of the study program; Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Gjatë vizitës në institucion si dhe në bazë të dokumentacionit të ofruar, GVJ vlerëson se universisteti Epoka ka implementuar platforma online (e-learning) për automatizimin e menaxhimit të studentëve dhe personelit, duke ofruar katër sisteme të automatizuara SMM, SAB, Dspace dhe Turnitin të cilat u vijnë në ndihmë si personelit akademik ashtu edhe studentëve. Stafi akademik



	<p>bashkëlidh detyra, leksione, libra, pyetësorë apo shpallin njoftime në këto sisteme kurse studentët marrin njoftimet, shkarkojnë leksionet, librat, njoftohet mbi notat, pikët e përfuara nga seminarët, detyrat e kursit, esetë, etj. Turnitin shërben për kontrollin digital të punimeve të studentëve për plagjiaturë (detyra kursi, ese, etj).</p> <p><i>[Shënime të vizitës në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>GVJ vlerëson se sistemi elektronik i komunikimit të brendshëm (EIS) është një sistem interaktiv digital i cili përmbush nevojat e komunikimit akademik në kampus. Ky sistem përdoret nga të gjitha njësitë përkatëse në universitet sipas roleve të tyre dhe në pjesë të madhe nga studentët, Universiteti ka publikuar udhëzuesin për përdorimin e këtij sistemi dhe në takimin fizik studentët shprehin se sistemi është një hapësirë personale ku ata mund të marrin lehtësisht të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me aspektet e ndryshme të procesit mësimor në një kohë të shkurtër. Në kuadër të digitalizimit të komunikimit, universiteti Epoka përdor dhe shërbimet Google, Turnitin dhe LMS.</p> <p><i>[Aneks 27. EIS Guideline Lectures and Students; Shënime të vizitës në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Procesi i Temës së Diplomës në programin e studimit të ciklit të dytë në Ekonomiks kalon në procedura të mirëpërcaktuara. Detyrimet dhe të drejtat e studentëve janë referuar në shtojcën “Për Programet e Studimit të ciklit të dytë”. Pas përcaktimit të udhëheqësit të tezës, studenti fillon bashkëpunimin e ngushtë për zgjedhjen e temës, shkrimin e punimit, rishikimit deri në procesin e dorëzimit përfundimtar “Udhëzuesit të Temës”. Në këtë aspekt, GVJ, në bazë të rregullores dhe takimit fizik me studentët vlerëson se studentët marrin asistencë të personalizuar dhe mbështeten nga stafi akademik në zhvillimin e temës së diplomës.</p> <p><i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University “Regulation on Second Cycle Study Programs”; Aneks 63. Thesis Guideline; Shënime të vizitës në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentacionit vlerëson se në zbatim të Politikës së Universitetit Epoka “Për përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit” dhe “Manualit të Sigurimit të Cilësisë së Universitetit Epoka”, institucioni ngre struktura të veçanta të cilat koordinojnë, rishikojnë, përmirësojnë programet e studimit dhe cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Struktura përgjegjëse e cila koordinon dhe bashkërendon me njësitë bazë procesin e brendshëm dhe të jashtëm të përmirësimit të cilësisë është Komisioni i përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Ky komisioni ka autonomi operative dhe siguron përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe mësimdhënies nëpërmjet raporteve të vlerësimit, inspektimeve periodike dhe monitorimit të përmirësimit të cilësisë në institucion. Nën strukturat e Komisionit të Përhershëm të sigurimit të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</li> <li>• Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave</li> <li>• Bordi i Provimeve.</li> </ul> <p>Përmes bazës së të dhënave të vlerësimit, Universiteti Epoka merr masat e nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të studimit dhe mësimdhënies. Thuhet se në baza vjetore, departamentet përgatisin raporte për rezultatet e vlerësimit të instruktorit të lëndës por në shtojcën “Raporti vjetor i departamentit” nuk jepet informacion mbi vlerësimin e instruktorëve të lëndës dhe nuk është e qartë sesi dhe ku raportohen këto vlerësime.</p> <p><i>[Aneks 12. Policy of EPOKA University “On Continuous Improvement of Study Program”; Aneks 38. EPOKA Quality Assurance Handbook; Aneks 20. Department Annual Report]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Ekonomiksit, pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative.</p> <p>Departamenti i Ekonomiksit është përgjegjës dhe kujdeset për cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e ciklit të dytë të studimit. Departamenti promovon, planifikon, zhvillon, organizon dhe menaxhon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor duke rritur në këtë mënyrë vetëdijen e personelit akademik dhe studentëve për cilësinë që programi i studimit ofron. Në baza vjetore përpilohet dhe publikohet “Raporti vjetor i departamentit” në të cilin analizohet situata dhe arritjet e vitit akademik të lënë pas.</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>[Aneks 2. The Statute of HEI; Aneks 20. Department Annual Report]</p> <p>GVJ vlerëson se Universiteti Epoka dhe Departamenti i Ekonomiksit përdorin mekanizma të ndryshëm për zhvillimin e metodave të ndryshme inovative në mësimdhënie duke përfshirë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Kurrikulat dhe stafi akademik ndërkombëtar, ofrojnë ekspertizë ndërkombëtare dhe inovatore në mësimdhënie.</li> <li>2) Mësimdhënien përmes aktiviteteve brenda dhe jashtë klasës, studentët marrin njohuri përmes aktiviteteve të ndryshme (leksioneve, grupeve të diskutimit, leksioneve të hapura publike, ndërveprimit me profesionistë, projekteve qytetare, etj).</li> <li>3) Numrin e vogël të studentëve, duke siguruar ndërveprim më të drejtëpërdrejtë student-pedagogë dhe krijimin e mundësisë për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies.</li> <li>4) Programet ndërkombëtare të lëvizshmërisë të studentëve dhe të stafit, i shërbejnë ndërkombëtarizimit të institucionit dhe shkëmbimit të praktikave dhe metodave më të mira dhe të reja të mësimdhënies.</li> </ol> <p>GVJ, gjatë bisedave me stafin akademik, u informua se pothuajse i gjithë stafi i Departamentit të Ekonomiksit ka qenë pjesë e shkëmbimeve ndërkombëtare dhe po ashtu ka pritur staf akademik të huaj. Studentët gjithashtu kanë qenë shumë aktiv. Në shtojcën “Lëvizshmëria e studentëve dhe stafit akademik” përcaktohet në detaje pjesëmarrja e departamentit të Ekonomiksit në këtë program.</p> <p>[Aneks 58. Student and staff mobilities table]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në bazë të “Listës së Publikimeve” për vitet akademike 2017-2020, , GVJ vlerëson se personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në kërkim shkencor sipas fushave të përcaktuara në “Vendimib e Komisionit Shkencor për Fushat e kërkimit”.</p> <p>GVJ u informua gjatë vizitës në institucion nëpërmjet bisedave me personelin akademik që pedagogët mbështeten nga institucioni në procesin e kërkimit shkencor edhe nëpërmjet financimit të pjesëmarrjes në konferenca apo të botimit të artikujve në revista të rëndësishme shkencore. Në vitin e fundit mbështetja financiare është dyfishuar sipas bisedave me stafin akademik gjatë vizitës fizike.</p> <p>Përveç publikimeve, stafi akademik është i përfshirë edhe në projekte shkencore sipas fushës së tyre të mësimdhënies duke bërë të mundur përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe metodologjisë së lëndëve respektive.</p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p><i>[Aneks 46. List of Publications; Aneks 48. Department Research Areas]</i></p> <p>GVJ bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion konstaton se institucioni në kuadër të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja kryen trajnime të vazhdueshme në lidhje me mësimdhënien, çështjet administrative dhe kërkimin shkencor për personelin akademik dhe atë administrative. Në shtojcën “Lista e aktiviteteve trajnuese për stafin” gjendet lista e plotë e trajnimeve për vitet akademike 2017-2020 ku dallohen trajnimet e zhvilluara së fundmi: Trajnimi “Për Edukimin Digital”, Workshop “Mbi modelin e inteligjencës emocionale SEI EQ”, etj. Këto trajnime tregojnë së universiteti Epoka vlerëson nevojat për trajnim sipas kohës dhe situatave të krijuara dhe siguron përmirësimin e aftësive të burimeve njerëzore para se të implementojë metoda të reja dhe inovative të mësimdhënies për të arritur cilësi të garantuar në procesin mësimor.</p> <p><i>[Aneks 39. List of Training Activities for Staff]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik bazuar në “Statutin e Universitetit Epoka” zotëron autonomi të plotë akademike dhe ka të drejtën/përgjegjësinë të përcaktojë metodat dhe përmbajtjen e procesit mësimor në përputhje me programin dhe politikat e përgjithshme të institucionit të cilat kanë primare përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p><i>[Aneks 2. Statuti Uni EPOKA shqip, neni 69]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ u informua gjatë bisedave me personelin akademik dhe drejtuesin e Departamentit të Ekonomiksit se departamenti është i angazhuar plotësisht në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe testimin e metodave të reja alternative në funksion të përthithjes së mirë të njohurive nga studentët. Stafit akademik në ndihmë iu vijon trajnimet e organizuara në nivel institucional dhe infrastruktura bashkëkohore.</p> <p>Metodat e përdorura në procesin mësimor vlerësohen në baza vjetore nga studentët dhe nga drejtuesit e institucionit por nuk është e qartë sesi raportohen dhe si veprohet nëse marrja e masave për ndryshim është e nevojshme.</p> <p><i>[Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave</p>	<p>Universiteti Epoka angazhon bashkëpunëtorët dhe partnerët në faza të ndryshme të programit të studimit kryesisht në formën e trajnimeve për të shkëmbyer ide dhe metoda të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Lektorë dhe kërkues shkencor ndërkombëtar përmes programit të lëvizshmërisë janë ftuar nga departamenti i Ekonomisë për të ndarë përvojën e tyre mësimore.</p>







Shkalla e përmbushjes sëstandardit				X
------------------------------------	--	--	--	---

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Bazuar në shtojcën “Syllabus i vitit akademik 2021-2022”, GVJ vlerëson se studentët testohen dhe vlerësohen për njohuritë e marra përmes mënyrave të ndryshme (detyra shtëpie, quize, pjesëmarrja në semianare, projekte, prezantime, test final etj) gjatë gjithë vitit akademik. Në syllabuset e lëndëve të programit të ciklit të dytë të studimit përcaktohen jo vetëm mënyrat e vlerësimit por edhe pesha që ato zënë në vlerësimin final. <i>[Aneks 18.1 18.2 Syllabus over year]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Provimet e zhvilluara (provime të ndërmjetme, përfundimtare, përsëritëse, etj) janë në formatin e printuar hard copy por i gjithë procesi i vlerësimit dhe i njoftimit të notës përfundimtare kryhet duke rruajtur anonimitetin e studentit duke eliminuar forma të ndryshme abuzimi. Në bazë të informacioneve të disponueshme, GVJ konstatoi se Universiteti Epoka nuk zhvillon provime elektronike.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në bazë të shtojcës “Udhëzues mbi provimet”, testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive të studentëve të programit të ciklit të dytë të Ekonomisë përgatitet nga titullari i lëndës/modulit përkatës dhe kontrollohet nga Komisioni i Bordit të Provimeve. Komisioni kontrollon dhe përgatit raporte sipas shtojcës “Formulari i Vlerësimit të Provimeve” lidhur me cilësinë e testit dhe jep rekomandime për përmirësim nëse shikohet e nevojshme. <i>[Aneks 35. Guideline -On Examinations; Aneks 36. Exam assessment Form]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Gjatë bisedave me studentët, stafin akademik dhe sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se testimi i vlerësimit të njohurive me shkrim zhvillohet në mënyrë anonime nëpërmjet sekretimit. Sistemi i vlerësimit me shkrim mbështetet nga infrastruktura e posaçme ku studentët monitorohen nga personeli akademik dhe kamera sigurie për të evituar çdo parregullsi dhe për të siguruar transparencë. <i>[Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e	GVJ u informua nga RVB se vlerësimi i njohurive të studentëve shoqërohet me komente dhe këshilla mbi procesin e mësimnxënies për të ndihmuar në përmirësimin e studentit në të ardhme. Gjithsesi kjo procedurë nuk është e mirëpërcaktuar në rregulloren e



<p>të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Universitetit apo në dokumentacionin e shkruar e vënë në dispozicion të GVJ. Nuk është e qartë se kur shikohet e nevojshme nga pedagogu përkatës të bëhen këto komente apo sesi komunikohen këto komente.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në bazë të shtojcës “Rregullorja e Universitetit EPOKA” neni 6 dhe 9, GVJ konstaton se njësia përgjegjëse dhe personeli akademik nuk e tolerojnë plagjiaturën dhe kopjimin nëpër provime dhe detyra të tjera. Për këtë qëllim, universiteti përdor softuerin Turnitin për të kontrolluar plagjiaturën për detyrat me shkrim të çdo lloji. Gjatë bisedave me studentët dhe pedagogët e këtij programi studimi GVJ u informua se stafi akademik dhe njësia bazë përpiqen të informojnë paraprakisht studentët edhe për rrjedhojat dhe sanksionet e parashikuara nëse ky nen mund të shkelet. [Aneks 64. Regulation of EPOKA University -On student Discipline; Shënime të vizitës në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Metodologjia dhe infrastruktura e vlerësimit të lëndëve të programit të ciklit të dytë, sipas RVB dhe komunikimeve me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore, bazohet mbi meritën personale të studentit duke eliminuar mundësinë për abuzime/favorizime. Provimet zhvillohen në anonimitet të plotë dhe pedagogu përkatës vlerëson dhe raporton notat në bazë të një sistemi sekretimi pa mundur të shoh emrat e studentëve në fletën e provimit. [Shënime të vizitës në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për tëu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se studentët e programit të ciklit të dytë të studimeve në Ekonomiks kanë të drejtën e rishikimit të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Shtojca “Për programet e ciklit të dytë” parashikon se studentët kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për rishikim brenda 5 ditëve nga njoftimi i rezultateve në sistemin elektronik SIE. Studentët njihen me të drejtën e rishikimit të vlerësimit që në fillim të vitit akademik përmes shtojcës “Udhëzuesi Smart Student”. [Aneks 6. Regulation of EPOKA University “Regulation on Second Cycle Study Programs”; Aneks 9. 2020-2021 Smart Student Guide]</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>GVJ konstaton se procedura e rishikimit/ankimimit është transparente dhe dokumentohet. Pedagogu përkatës shqyrton ankesën e studentit e cila finalizohet nga Dekanati përkatës duke ngritur një komision vlerësimi. Komisioni i vlerësimit pasi ka kontrolluar për gabime të mundshme materiale harton një raport të cilin e kalon për vendimarrje në dekanat. Studenti njoftohet brenda 15 ditësh për rezultatin e rishikuar dhe e gjithë procedura arkivohet nga Zyra e Regjistrimit.</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Në bazë të dokumentacionit të plotë të vendosur në dispozicion, GVJ vlerëson se programi i ciklit të dytë në Ekonomiks është ndërtuar në mënyrë që studentët e regjistruar të marrin njohuri të avancuara në fushën përkatëse dhe të zhvillojnë aftësi profesionale të veçanta. Në shtojcën “Syllabus i vitit akademik 2021-2022” përcaktohen qartësisht njohuritë e përgjithshme teorike dhe aftësitë e veçanta që studentët duhet të fitojnë prej secilës lëndë. Universiteti Epoka dhe stafi akademik i departamentit të Ekonomiks angazhohen maksimalisht për të garantuar përvetësimin e programit mësimor dhe marrjen e njohurive nga studentët. <i>[Aneks 18.1-18.2 Syllabus over year]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Gjatë takimeve me studentët dhe stafin akademik GVJ u informua se programi i ciklit të dytë të studimeve në Ekonomiks zhvillohet në gjuhën angleze dhe garanton njohuri në disiplina të ndryshme duke i ndërlidhur me fushën përkatëse të studimit. Sipas shtojcës “Kurrikula e programit të studimit Master” është e pasur me lëndët bazë dhe lëndët plotësuese që i përkasin fushës së komunikimit dhe teknologjisë si Shkrim Akademik, Metoda e Kërkimit, etj. <i>[Aneks 13. Curricula of the study program: Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Sipas RVB, GVJ konstatoi se kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studentët testohen në mënyrë të vazhdueshme përgjatë vitit akademik dhe analizohen/shqyrtohen në përfundim të lëndës pas zhvillimit të testit përfundimtar nga profesori përkatës i lëndës.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe	GVJ u informua nga RVB dhe takimet në institucion me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi se në përfundim të çdo lënde pedagogu përkatës diskuton për çështjet

*Beqir Elmas*



orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	më të rëndësishme të lëndës dhe i orienton studentët për provimin përfundimtar. <i>[Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ u informua nga drejtuesit, pedagogët dhe studentët se në funksion të këtij programi studimi, institucioni ofron periodikisht leksione të hapura për çështje të rëndësishme të lidhura me fushën e studimit dhe jo vetëm ku studentët kanë mundësinë e zgjerimit të dijeve dhe prezantimit me risi të reja në fushën e teknologjisë. Sipas shtojcës “Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020” leksione të hapura zhvillohen edhe nga ekspertë të njohur të fushës nga institucionet partnerë brenda dhe jashtë vendit, si dhe bizneset me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. <i>[Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020_shqip; Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’iu japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Në takimin me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se në funksion të zhvillimit të aftësive praktike studentëve iu krijohet mundësia të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale për aq sa lejon fusha e studimit. Në shtojcën “Syllabus i vitit akademik 2021-2022” përcaktohen qartësisht pritshmëritë mbi aftësitë praktike që lëndët përkatëse ofrojnë dhe metodologjia e përdorur për arritjen e tyre. <i>[Aneks 18.1-18.2 Syllabus over year; Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	GVJ u informua nga takimi me studentët dhe stafin akademik se diskutimet dhe puna në grup zënë një pjesë të rëndësishme të programit mësimor dhe të vlerësimit përgjatë vitit akademik. Të përcaktuara sipas lëndëve përkatëse në shtojcën “Syllabus i vitit akademik 2021-2022”, diskutimet dhe puna në grup synojnë të adresojnë problemet dhe çështjet aktuale të lidhura me fushën e studimit duke u njohur me qëndrimet e ekonomistëve/ekspertëve dhe duke ofruar pikëpamjet vetjake. <i>[Aneks 18.1-18.2 Syllabus over year; Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	GVJ u informua nga RVB dhe takimi fizik se stafi akademik motivon studentët të zhvillojnë ide novatore si dhe studime të avancuara kërkimore dhe shkencore në të gjitha lëndët e programit të ciklit të dytë të studimeve nëpërmjet detyrave të kursit. Universiteti Epoka edhe jashtë strukturës së programit mësimor mbështet dhe krijon mundësi që studentët të marrin



	pjesë në seminare, konferenca studentore kombëtare dhe ndërkombëtare çdo dy vite. [Shënime të vizitës në institucion]			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni ndjek jo vetëm një politikë të mbështetjes së ideve inovative por i promovon ato tek studentët duke ofruar edhe mbështetjen financiare. Sipas RVB dhe dokumentave të vëna në dispozicion GVJ konstatoi aktivitete të tilla si: Klubet studentore të financuara nga Universiteti Epoka apo bashkëpunime student-pedagog për botime të punimeve shkencore. Departamenti i Ekonomiksit ka klubin studentor përkatës “Rrjeti i Ekonomistëve të Rinj” ku studentët mund të promovojnë dhe të zhvillojnë idetë e tyre që lidhen me fushën e studimit. [Aneks 20. Department Annual Report]			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Një nga prioritetet strategjike është bashkëpunimi me institucione si motra të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit me qëllim ndërkombëtarizimin dhe rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik në të njëjtën kohë. Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, shtojca “Marrëveshjet e bashkëpunimit me praktikant profesional” dhe shtojca “Tabela e lëvizshmërisë së studentëve dhe stafit akademik”, GVJ vlerëson se Universiteti Epoka ndërthur format e mësimdhënies me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar për të rritur lëvizshmërinë e studentëve. [Aneks 43. Cooperation agreements and Professional Practice; Aneks 58. Student and staff mobilities table]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Universiteti Epoka ka të mirëpërcaktuar të gjithë procedurën lidhur me mbrojtjen e diplomës dhe informacionin e bën publik në faqen e internetit. Studentët gjithashtu mbështeten dhe mund të marrin informacion të detajuar nga këshilltari i klasës dhe pedagogu i



	caktuar si udhëheqës në procesin e shkrimit dhe mbrojtjes së diplomës.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Gjatë takimeve me drejtuesin e departamentit, pedagogët dhe studentët GVJ u informua se studentëve ju vihen në dispozicion të gjitha materialet e nevojshme sqaruese për mbrojtjen e diplomës. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike në baza javore me studentët dhe i vënë në dispozicion të gjithë informacionin dhe materialet e nevojshme si psh shtojcën “Udhëzuesi i Temës së Diplomës”. <i>[Aneks 63. Thesis Guideline; Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Universiteti Epoka nuk parashikon zhvillimin e provimit final për programin e ciklit të dytë të studimeve në Ekonomiks. Njohuritë e marra gjatë dy viteve akademike testohen vetëm nëpërmjet një punimi përfundimtar diplome. <i>[Aneks Tabelat Përmbledhëse]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Gjatë takimeve me studentët dhe stafin akademik GVJ konstatoi se stafi akademik orienton studentët në përcaktimin e temave të diplomës. Çdo studenti i përcaktohet një pedagog i cili e drejton dhe mbështet përgjatë gjithë rrugëtimit të punimit përfundimtar të diplomës. <i>[Shënime të vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Universiteti Epoka dhe Departamenti i Ekonomiksit është i pajisur me infrastrukturën e duhur shkencore dhe aplikative të cilën e vendos në funksion të studentëve për të arritur qëllimet specifike të studimit. Studentët udhëzohen të përdorin literaturën fizike dhe digjitale të revistës shkencore JSTOR si dhe softuer-et aplikative për të zhvilluar analiza dhe matje statistikore.
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Pedagogu përgjegjës për udhëheqjen e temës së diplomës në përfundim të procesit të asistimit dhe shkrimit të temës nga studenti duhet të vlerësojë nëse punimi i diplomës është i plotë dhe në përputhje me udhëzuesit e miratuar nga universiteti. Pedagogu udhëheqës plotëson një raport vlerësimi sipas shtojcës “Formulari i dorëzimit të tezës së masterit” ku garanton cilësinë dhe origjinalitetin e punimit dhe miraton ose jo paraqitjen e punimit para komisionit të diplomës. <i>[Aneks 68. Master Thesis Form]</i>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në bazë të shtojcës “Syllabus i vitit akademik 2021-2022”, GVJ konstatoi se studentët testohen dhe vlerësohen me notë për punimin përfundimtar të temës së diplomës. Departamenti i Ekonomiksit ka



	parashikuar temën e diplomës si lëndë e veçantë me 30 kredite në programin e ciklit të dytë të studimeve. Nota përfundimtare përcaktohet nga juria e komisionit të diplomave. <i>[Aneks 18.1-18.2 Syllabus over year]</i>								
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	GVJ konstatoi se studentët pajisen me diplomë të Masterit Shkencor në Ekonomiks dhe si rrjedhojë dhe suplementin e diplomës nëse përfundojnë me suksese ngarkesën mësimore dhe punimin e diplomës duke arritur një total prej 120 kreditesh.								
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve zyrat përkatëse harton dhe e pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). Gjithashtu sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe informacionit që morëm në institucion GVJ u informua se në përfundim të studimeve studenti ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar.  <i>[Aneks 14. Diploma Supplement Model; Shënime të vizitës në institucion]</i>								
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Sipas RVB, të gjitha dokumentet në lidhje me studentët gjatë periudhës së tyre të studimeve arkivohen nga zyrat përkatëse përtej periudhës dyvjeçare të studimeve. Në këtë mënyrë, universiteti është në gjendje t'i përgjigjet kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të studentëve në lidhje me dokumentacionin e periudhës së studimit në çdo kohë.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.**




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore e IAL-së. Kjo Zyrë është përgjegjëse për të mbledhur dokumentacionin dhe për të ndjekur procedurat në lidhje me rekrutimin e stafit të ri të të gjitha kategorive, për të përditësuar dokumentacionin e stafit ekzistues dhe për të ndjekur procedurat ligjore për marrëdhënien kontraktuale të tyre me institucionin. Mbledhja e të dhënave bëhet mbi bazën e një formulari tip, i cili plotësohet nga personeli me kohë të plotë dhe të pjesëshme. Ruajtja e të dhënave të personelit bëhet në dy mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• me një dosje personale fizike në ZBNj;</li> <li>• me një dosje elektronike në Sistemin Interaktiv Epoka, që përditesohet në bazë të informacionit të paraqitur në Zyrën e Burimeve Njerëzore;</li> </ul> <p>Ndërsa të dhënat që lidhen me veprimtarinë mësimore dhe kërkuese të stafit akademik mblidhen, përpunohen dhe raportohen nga departamenti. Këtu përfshihet cikli dhe PS ku angazhohet, lënda dhe ngarkesa që mbulon në çdo semestër, veprimtaria kërkimore dhe publikimet. Në faqen e internetit të departamentit janë të publikuara CV e stafit akademik ku përfshihet informacion mbi edukimin, projektet e përfshira, interesat kërkimore, lëndët ku është angazhuar në vite, lista e publikimeve, etj.</p> <p>GVJ kontrollon në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe vërejtë se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit.</p> <p><i>[Aneks 25. The personal staff file format; Shënimet gjatë vizitës; <a href="https://epoka.edu.al/eco-academic-staff.html">https://epoka.edu.al/eco-academic-staff.html</a>; <a href="http://eis.epoka.edu.al/">http://eis.epoka.edu.al/</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe miratuar procedura për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe Kodin e Punës në RSH. Procedurat e rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik janë të sanksionuara në nenet e pjesës së tretë të statutit të UE. Procedurat zbatohen në mënyrë rigorozë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentet. IAL ka miratuar dhe zbaton</p>





	<p>një rregullore për rekrutimin e stafit, e cila ka për qëllim të përcaktojë kushtet që duhet të plotësohen në rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik dhe administrativ. GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi që DBNJ zbaton me rigorozitet procedurat për rekrutimin e stafit, të cilat janë të hapura, nxisin përthithjen e personave me kualifikime dhe janë treansparente.</p> <p><i>[Aneks 2. The Statute of HEI neni 68 dhe neni 76; Aneks 11. Regulation of EPOKA University "On Staff Recruitment"]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret e posaçme dhe specifike vendosen nga Njësia bazë, që është Departamenti. Disa nga kriteret që përmban forma e aplikimit janë fusha dhe ciklet e studimit, eksperiencia në mësimdhënie, publikimet, pjesëmarrja në projekte, etj. Ekziston një pikëzim për secilin kriter dhe për çdo pozicion ka një numër minimal pikësh të kërkuara. Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe specifike. Ndërsa aplikimet shqyrtohen në Fakultet dhe departament, ku ngrihet komisioni për shqyrtimin e aplikimeve. Kandidatët për staf akademik ftohen gjithashtu për të mbajtur një leksion të hapur. Të gjitha pozicionet e hapura publikohen në web faqen e Universitetit, tek menuja e burimeve njerëzore.</p> <p><i>[Aneks 11. Regulation of EPOKA University "On Staff Recruitment"; <a href="https://hr.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html">https://hr.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html</a>; Shënimet gjatë vizitës]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Rregullorja për rekrutimin e stafit përmban të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. ZBNJ drejton të gjithë procesin. Nevojat për vende të reja hapen me vendim të Bordit të Administrimit. ZBNJ e fillon procesin pasi merr kërkesën nga Njësia bazë. Pozicionet e lira bëhen publike në faqen e internetit të IAL ose në faqe të agjencive ndërkombëtare. Aplikimet bëhen online dhe përzgjedhja bëhet nga një komision. Për stafin akademik parashikohet dhe një leksion i hapur, në të cilin marrin pjesë antarët e komisionit. Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, takimin me stafin akademik dhe stafin e ZBNJ, GVJ konfirmoi që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</p> <p><i>[Aneks 11. Regulation of EPOKA University "On Staff Recruitment"; Aneks 60. EPOKA University Academic Staff</i></p>





	<i>Application Form; Shënimet gjatë vizitës: <a href="https://hr.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html">https://hr.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html</a></i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### **Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>UE ka ambiente të përshtatshme dhe të bollshme për personelin sipas të gjitha kategorive (në total rreth 1680m<sup>2</sup>), ku përfshihen zyra për personelin drejtues dhe atë akademik, dhe zyrat për administratën. GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi që infrastruktura ekzistuese e institucionit plotëson kushtet e nevojshme dhe është e përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Personeli akademik ka zyra të veçanta dhe po ashtu edhe zyra mbledhjesh dhe takimesh. UE disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, salla interneti, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme mësimore (rreth 8 mijë m<sup>2</sup> ose 6.02m<sup>2</sup> për student). Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka, Sekretaria mësimore, etj. janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre.</p> <p><i>[Aneks- Tabelat Përmbledhëse; Aneks 45. Infrastructure in function of the study program Shënimet gjatë vizitës]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Universiteti EPOKA ka organizuar në mënyrë periodike trajnime për personelin akademik me synimin që të rrit aftësitë e tyre mësimdhënëse dhe aftësitë për punë kërkimore. Planifikimi i trajnimeve dhe tematika e tyre është mbështetur në vlerësimin e nevojave. Disa nga trajnimet e zhvilluara janë mbi metodat e mësimdhënies, trajnim për metodat e kërkimit dhe seminare për hartimin e syllabuseve, trajnime mbi edukimin digjital, ndikimin e ndërkombëtarizimit, metodat e ndryshme të mësimdhënies, për të zhvilluar kompetencat në planifikimin, shkrimin dhe menaxhimin e projekteve Erasmus+, trajnime për përdorimin e platformës Microsoft Teams, për zhvillimin e provimeve online, ndarjen e eksperiencave më të mira në mësimdhënie, etj. Personeli akademik</p>



	<p>është inkurajuar gjithashtu të marrë pjesë në programet Erasmus+ ku kanë shkëmbyer përvoja dhe janë njohur me politikat e menaxhimit dhe zhvillimit në institucionet e arsimit të lartë në Evropë. GVJ nga vizita në institucion dhe dokumentacioni konstatoi që IAL ka organizuar sistematikisht trajnime me personelin duke adresuar nevojat e tyre.</p> <p><i>[Aneks 39. List of Training Activities for Staff]</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Sic përmendet në listën e trajnimeve të realizuara institucioni ka organizuar trajnime specifike për të kualifikuar më tej stafin e tij për përdorimin e teknologjive të reja në procesin mësimor-shkencor. Kështu në 20 Maj 2020 institucioni ka zhvilluar një trajnim për përdorimin e platformës Microsoft Teams, në 7 Korrik 2020 për përdorimin e platformës online të provimeve dhe në 16 Tetor 2020 për organizimin e mësimit online. GVJ konstatoi gjatë takimeve në institucion që njohuritë e marra kishin ndihmuar stafin për të realizuar mësimdhënien online gjatë periudhës së pandemisë dhe për futjen e metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p><i>[Aneks 39. List of Training Activities for Staff; Shënimet gjatë vizitës]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit planifikon kohën vjetore të punës sipas nevojave për realizimin e procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve. Sipas evidencave të dorëzuara për ngarkesën semestrale të personelit akademik i angazhuar në këtë program studimi për vitin 2021-2022, konstatohet që janë angazhuar 11 personel akademik, nga të cilët 4 janë PAK. PAE i angazhuar në këtë PS mbulon orë mësimore në auditor që variojnë nga 96 orë mësimore deri në 200 orë mësimore vetëm për semestrin e vjeshtës. GVJ gjykon që ngarkesa është në përputhje me Udhëzimin nr. 29, datë 10/09/2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL".</p> <p><i>[Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 4; Shënimet gjatë vizitës]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.3**



<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>IAL e përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike dhe praktike në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe modulet përkatëse. Godina ku gjendet Fakulteti Ekonomik dhe zhvillon mësimdhënien e PS, Departamenti i Ekonomiksit ka hapësira të mjaftueshme për numrin e studentëve (14 në të dy vitet) që ka aktualisht. Klasat e seminareve/leksioneve janë 20 dhe sipërfaqja m<sup>2</sup>/për student është 6.02.</p> <p>GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe konfirmon se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral, eliminimin e zhurmave dhe ish-in të pajisura me sistem ngrohje dhe kundrazjarrit. Biblioteka po ashtu ishte në një ambient të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme.</p> <p><i>[Aneks- Tabelat Përmbledhëse, tabela 16; Aneks 45. Infrastructure in function of the study program: Shënimet gjatë vizitës]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konfirmoi gjatë vizitës në institucion që auditorët ishin të gjithë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme (tabela, videoprojektor dhe PC) për një proces efektiv mësimor në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p><i>[Aneks 45. Infrastructure in function of the study program: Shënimet gjatë vizitës]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për realizimin e PS janë gjithashtu në dispozicion katër laboratorë kompjuterikë të pajisur plotësisht me 128 PC. Për të mundur një proces efektiv të mësimdhënies dhe mbështetur studentët në veprimtarinë mësimore dhe kërkimore, janë instaluar programe kompjuterike, të cilat mund të përdoren dhe nga studentët e PS "Msc në Ekonomiks" si: Windows: MS Office, Matlab, SPSS, EViews. Zyra Koordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit përditëson programet në laboratorët e kompjuterave çdo semestër, bazuar në kërkesat e personelit akademik.</p> <p><i>[Aneks 45. Infrastructure in function of the study program: Shënimet gjatë vizitës]</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucionin konfirmoi që IAL ka laboratorë të pajisur mirë të teknologjisë së informacionit të cilat janë të pajisura me programet të nevojshme për të realizuar një proces mësimdhënie efektiv dhe realizimin e punëve individuale të studentëve. Laboratorët mund të përdoren nga studentët për të përgatitur detyrat dhe punimet e tyre të diplomës. Në këto laboratore realizohen dhe disa shërbime si Shërbimet e Mësimdhënies (Turnitin, Sistemi i Menaxhimit të Mësimin (LMS), Shërbimet e Google, Sistemet Interaktive EPOKA (EIS), etj.</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, referuar vizitës në institucion, GVJ shprehet se ky kriter nuk aplikohet për programin në fjalë. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ka 44 marrëveshje, të cilat mund të shfrytëzohen për realizimin e praktikave profesionale. Aktualisht në planin mësimor nuk del praktika profesionale si lëndë e veçantë.</p> <p><i>[Aneks: Tabelat përmbledhëse shqip, tabela 5]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UE disponon një bibliotekë, me sipërfaqe 400m<sup>2</sup> dhe kapacitet 100 vende. Këto mjedise mund të shfrytëzohen nga studentët e këtij programi studimi. Studentët dhe stafi akademik mund të antarësohen për të shfrytëzuar burimet e bibliotekës. GVJ vizitoi bibliotekën dhe konfirmoi që ambjenti ishte i hapur, me ajër dhe ndriçim natyral, me vendosje të tavolinave në mënyrë që shfrytëzimi i tyre të bëhet në mënyrë të barabartë nga studentët. Fondi i librave është i hapur dhe mund të konsultohet lirshëm nga studentët. Studentët kanë të drejtë të huazojnë libra dhe t'i mbajnë ato deri në 15 ditë dhe maksimumi i tekseve që mund të marrin njëkohësisht është 3.</p> <p><i>[Shënime gjatë vizitës; <a href="http://library.epoka.edu.al/cat-regulations-484.html">http://library.epoka.edu.al/cat-regulations-484.html</a>]</i></p>

*Buletin*



<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe evidencave biblioteka ka një fond prej 25000 libra dhe 2000 revista akademike dixhitale. Literatura është bashkëkohore dhe një pjesë e konsiderueshme reflektohet në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Institucioni siguron një numër të konsiderueshëm të teksteve mësimore bazë dhe literaturë ndihmëse. Numri i titujve në funksion të këtij programi është është 881. Fondi i librave mund të konsultohet gjithashtu online. Bazuar në kërkesat e personelit akademik fondi është zgjeruar për çdo vit akademik dhe është vendosur në shërbim të studentëve.</p> <p><i>[Aneks 26. List of books or periodicals in the Library; <a href="http://lib.epoka.edu.al/">http://lib.epoka.edu.al/</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konfirmoi që UE ka anëtarësim të plotë në JSTOR, që ka 2000 revista akademike. Çdo anëtar i personelit akademik ka akses në koleksionet e JSTOR dhe mund të shkarkojnë disa artikuj në mënyrë periodike.</p> <p>Studentët mund të kërkojnë libra në <a href="http://lib.epoka.edu.al/">http://lib.epoka.edu.al/</a> ose mund të kenë akses në koleksionet e JSTOR duke shkuar në lidhjen <a href="http://www.jstor.org/">http://www.jstor.org/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Aktualisht biblioteka është me fonde të hapura, ka pajisje elektronike dhe akses në internet, e cila iu mundëson studentëve shfrytëzimin e fondeve të bibliotekës online. Fondi i bibliotekës është i gjithi i digjitalizuar dhe studentët mund ta konsultojnë atë online. <i>[<a href="http://lib.epoka.edu.al/">http://lib.epoka.edu.al/</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstatoi që UE e pasuron fondin e librave përmes donacioneve dhe blerjeve në vite. Kërkesa për tituj të rinj bëhet nga personeli akademik i departamentit të Ekonomiksit. IAL nuk ka dorëzuar ndonjë evidencë për ta verifikuar këtë procedurë.</p> <p><i>GVJ gjykon se shtimi i fondeve përmes blerjeve është një praktikë e mirë dhe duhet të vazhdojë, pasi mundëson jo vetëm pasurimin e fondeve, por dhe përditësimin e literaturës.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që orari i bibliotekës është çdo ditë të javës 08:30 – 12:30/13:30 - 17:30 dhe ditën e Shtunë 9:00-13:00. Oraret e shërbimit janë të përshtatshme për studentët e këtij programi studimi. Nga personeli i bibliotekës u konfirmua se studentët e</p>



	<p>frekuentonin bibliotekën kryesisht gjatë periudhave të provimeve, në pushimet midis orëve ose kur punonin për kryerjen e detyrave në grup dhe duhet të konsultonin literaturën.</p> <p>[<a href="http://library.epoka.edu.al/home.html">http://library.epoka.edu.al/home.html</a>]</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UE përdor Sistemin Interaktiv Epoka (EIS), një sistem i brendshëm që menaxhon të gjitha informacionet. Sistemi është i konfiguruar me role të përcaktuara dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar. Çdo student pajiset me email-in e tij dhe mund të regjistrohet në llogarinë personale të studentit në EIS.</p> <p>Ndërfaqja e studentëve përmban informacione dhe të dhëna në lidhje me kurset e marra nga studentët, notat, frekuentimin, financat, informacione brenda kampusit, informacione personale të studentëve. Sistemi ofron informacione për vitin aktual akademik.</p> <p>[Aneks 27. EIS Guideline Lectures and Students]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>EIS i mundëson personelit akademik dhe atij administrativ disa funksionalitete për të ndjekur dhe menaxhuar rezultatet akademike të studentëve, frekuentimin dhe gjithashtu disa funksione të përgjithshme që i përkasin statusit të personelit. Të gjithë përdoruesit kanë akses në të dhëna dhe mund të gjenerojnë raporte sipas të drejtave të miratuara nga administratori i sistemit. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që EIS menaxhon të gjithë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetet e personelit akademik dhe administrativ në mënyrë hierarkike. Ai është një sistem funksional dhe një instrument efektiv për menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit.</p> <p>[Aneks 27. EIS Guideline Lectures and Students]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të</p>	<p>EIS siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin</p>

*Anty E. Selby*



<p>gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin informatik EIS dhe merr informacione të dedikuara në varësi të statusit. Kështu studentët në profilin e tyre kanë akses në të dhënat personale dhe ato që lidhen me programin e studimit. Regjistrimi i lëndëve realizohet përmes sistemit dhe studentët mund të shohin pjesëmarrjen në mësim, datat e provimeve, rezultatet e provimeve të ndërmjetme dhe provimeve përfundimtare. Ata mund të aksesojnë gjithashtu përmes profilit të tyre kurrikulën e programit, orarin javor të mësimin, kërkesat dhe njoftimet, transkriptin. Ndërsa stafi akademik ka akses në të gjithë informacionin që lidhet me lëndën në semestrin aktual dhe në kurset e zhvilluara më parë, mund të përditësojë programin e lëndës, të plotësojë pjesëmarrjen e studentëve në mësim dhe rezultatet e provimeve.</p> <p><i>[Aneks 27. EIS Guideline Lectures and Students]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>UE ka dhe një sistem të menaxhimit të mësidhënies (LMS) i cili lehtëson komunikimin interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis pedagogeve dhe studenteve në kohe reale. Sistemi bazohet në Moodle, mundëson aksesin, koordinimin dhe organizimin e lëndëve në internet. Studentët dhe instruktorët mund të identifikohen në LMS duke përdorur llogarinë zyrtare të emailit dhe përmes platformës mund të kenë komunikime interaktive. Studentët dhe lektorët përdorin gjithashtu Google Classroom në kuadër të platformës Google Suite që aksesohet nga personeli dhe nga studentët me anë të emailve zyrtare të institucionit.</p> <p><i>[<a href="http://lms.epoka.edu.al/course/index.php?categoryid=388">http://lms.epoka.edu.al/course/index.php?categoryid=388</a>: Shënimet gjatë vizitës]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Për të gjithë përdoruesit e tij, sistemi i menaxhimit EIS siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik, administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për ta. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre të personalizuara sipas roleve dhe njësive përkatëse. Stafi akademik dhe administrativ çlirohen nga detyrat e lodhshme manuale. EIS u siguron atyre informacione të azhurnuara dhe i ndihmon ata të marrin vendime të informuara bazuar mbi të dhëna. Kështu të gjithë përdoruesit mund të përditësojnë CV dhe mund të menaxhojnë aktivitetin e përditshëm sipas rolit dhe pozicionit që kanë. Sistemi përdoret gjithashtu nga koordinatorët e departamenteve dhe fakulteteve për caktimin e kurseve dhe monitorimin e aktivitetit akademik; Zyra e Pranimeve</p>



	dhe Zyra e Regjistrimit për të menaxhuar të gjithë informacionin që lidhet me pranimin, regjistrimin dhe bursat e studentëve; Zyra e Financës dhe ajo e Burimeve Njerëzore për të menaxhuar të gjithë informacionin që lidhet me detyrimet financiare dhe ato të marrëdhënieve të punës. [Shënimet gjatë vizitës]		
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Faqja e internetit të UE paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët, projektet dhe shërbimet për studentët në anglisht. Informacioni në gjuhën shqipe është kryesisht për institucionin dhe pranimet. Departamenti ka dhe faqen e vet, ku jep informacion më të dedikuar për studentët e PS. Informacioni në këtë faqe është vetëm në anglisht, pasi dhe mësimdhënia në të tre ciklet e studimit bëhet në anglisht. [ <a href="http://www.epoka.edu.al/">http://www.epoka.edu.al/</a> ; <a href="https://eco.epoka.edu.al/">https://eco.epoka.edu.al/</a> ]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi IV.6</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni harton një Raport Financiar, i cili është pjesë përbërëse e raportit vjetor. Në këtë raport paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar. Hartimi i buxhetit është një proces ku përfshihen shumë aktorë. Kështu Rektori iu kërkon në tremujorin e parë (janar-mars) të gjitha Fakulteteve, Njësive bazë dhe Njësive të tjera të Universitetit të paraqesin nevojat për burime njerëzore dhe për investime që lidhen me infrastrukturën, pajisjet dhe pajisjet që lidhen me teknologjitë e informacionit, publikimet dhe shpenzimet për të siguruar akses në bibliotekat digjitale. Të gjitha njësitë mbështeten tek plani strategjik 2018-2022 i UE për hartimin e kërkesave. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative harton gjithashtu një plan buxhet me zërat respektiv për mbulimin e të gjithë programeve të studimit, të cilin e paraqet në Rektorat. Kërkesat e të gjitha njësive konsolidohen në Rektorat dhe i dërgohen Administratorit, i cili harton projektbuxhetin në nivel institucioni. Bordi i Administrimit diskuton dhe miraton



	<p>buxhetin e UE. Sipas raportit vjetor të institucionit kostoja mesatare për një student në vitin akademik 2019-2020 ka qënë 1648 Euro.</p> <p><i>[Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020_shqip]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Departamenti dhe Fakulteti përcjell projekt buxhetin për të gjitha programet e studimit, i cili përmban shpenzimet për paga, shpenzime të tjera operative dhe investimet. Bordi Administrativ aprovon buxhetin vjetor dhe afatmesëm të institucionit bazuar në nevojat e Njësive bazë dhe Njësive kryesore, dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Burimi kryesor i të ardhurave janë tarifatat e studentëve (96.9% për vitin 2020-2021). Fondet e tjera përfshijnë financimet e projekte kërkimore ndërkombëtare dhe fonde të tjera kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare. Në pjesën e shpenzimeve zërat kryesorë janë shpenzimet e stafit (59.2%), shpenzimet për kërkim dhe zhvillim (11.3%) dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime (12.9%) dhe investimet (10.4%). Pas miratimit të buxhetit nga Bordi Administrativ, Zyra e Financave në bashkëpunim me Administratorin ndjek shpërndarjen dhe zbatimin e buxhetit.</p> <p><i>[Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020_shqip, fq.99]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Universiteti Epoka funksionon si institucion brenda kompanisë "Turgut Ozal Education" sh.a dhe auditimi vjetor i jashtëm në lidhje me situatën financiare kryhet nga kompania si një i tërë. Raporti i auditit gjendet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Turgut Ozal Education sh.a.. Raporti përmban analizën e të dhënave për shpenzimet dhe të ardhurat e kompanisë dhe institucioneve të përfshira në të, të gjitha hyrjet që lidhen me të ardhurat (grante, tarifatat e studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ai ofron drejtpërdrejt ose indirekt (duke iu dhënë shërbime të jashtme kompanive). Sipas RVB një kopje e raportit të auditimit vjetor gjendet në Zyrën e Financave të Universitetit Epoka.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion GVJ konfirmoi që raporti financiar hartohet nga Drejtorja e Përgjithshme e Turgut Ozal Education sh. a. Të dhënat dhe analizat i komunikohen Universitetit Epoka, një kopje e tij gjendet në Zyrën e Financave dhe një tjetër në Zyrën e Administratorit.</p> <p>GVJ konstatoi që UE ka një pjesë të raportit financiar në raportet vjetore për vitin korrent dhe paraardhes ku edhe paraqitet një analizë e përgjithshme mbi të ardhurat dhe shpenzimet.</p> <p><i>[Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020_shqip, fq.99]</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Sipas raporteve vjetore të institucionit të ardhurat janë më të mëdha se shpenzimet për tre vitet e fundit. GVJ konstatoi bilanc pozitivë për të gjithë periudhën, e cila garanton qëndrueshmërinë financiare të IAL. Tendenca e të ardhurave nga tarifat e studentëve është në rritje për të gjithë periudhën, ndërkohë që shpenzimet janë rritur më pak se të ardhurat.</p> <p><a href="https://epoka.edu.al/mat/reports/raporti-vjetor-2020-2021.pdf">https://epoka.edu.al/mat/reports/raporti-vjetor-2020-2021.pdf</a>  <a href="https://epoka.edu.al/mat/administration/Annual_Report_2019_2020_(Albanian).pdf">https://epoka.edu.al/mat/administration/Annual_Report_2019_2020_(Albanian).pdf</a>  <a href="https://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019.pdf">https://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
-----------------------------------------------------------------	--	------------------------------	-----------------------------	--------------------------------------------------------------------------

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p><b>Standardi V.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UE është institucion jopublik i arsimit të lartë, që e zhvillon veprimtarinë e vet mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi. UE ka miratuar statutin mbështetur në kërkesat e ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe disa rregullore dhe procedura të cilat specifikojnë hapat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. Për programet e studimit të ciklit të dytë IAL ka hartuar një rregullore të veçantë ku janë përfshirë të gjitha elementët se si duhet të funksionojnë këto programe studimi. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në</p>

*Beke* *Shkollë*



	<p>përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu kuotat e pranimit miratohen nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik (propozim që mbështetet në propozimet e Njësive kryesore). Nota mesatare për tu pranuar në programin e studimit dhe kriteret të tjera miratohen nga Dekanati, mbështetur në propozimet e Njësive bazë, ndërsa për njohjen e gjuhës angleze është përcaktuar niveli B2. Për pranimet në këtë cikël studimi, të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit dhe të ndjekin procedurën e regjistrimit të publikuar në anglisht në faqen e UE.</p> <p><i>[Aneks 2. Statuti Uni EPOKA shqip, nenet 89-93; Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs"; <a href="https://admissions.epoka.edu.al/">https://admissions.epoka.edu.al/</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Statutit, i Rregullores së programit të studimit të ciklit të dytë dhe takimet me personelin akademik, Zyrën e Pranimeve dhe studentët GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek UE nga hyrja në daljen e studentëve të ciklit të dytë garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Të drejtat e studentëve paraqiten të plota në kreun V të Rregullores së programit të studimit të ciklit të dytë dhe nenin 117 të Statutit.</p> <p><i>[Aneks 2. Statuti Uni EPOKA shqip, nenet 117; Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", kreu V; <a href="https://admissions.epoka.edu.al/">https://admissions.epoka.edu.al/</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konfirmoi që kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes së studentëve, vlerësimi i dijeve të tyre, transferimit, njohja e studimeve të mëparshme dhe diplomimi janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e programeve të studimit të ciklit të dytë. Të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me pranimin, procedurat dhe dokumentat e regjistrimit, tarifën, bursat dhe transferimin e studimeve janë të publikuara në faqen e internetit të Zyrës së Pranimit të Universitetit EPOKA. Informacioni publikohet gjithashtu dhe në rrjetet sociale në faqen e universitetit.</p> <p><i>[<a href="https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=master-of-science&amp;catid=1928&amp;menuid=1930">https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=master-of-science&amp;catid=1928&amp;menuid=1930</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për tëu pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>UE ka përcaktuar dy kriteret të veçanta për pranimin e studentëve në ciklin e dytë në PS Master Shkencor në anglisht, ku përfshihet dhe programi "Msc në Ekonomiks":</p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kandidatët duhet të zotërojnë një diplomë Bachelor në këtë fushë ose fusha të përafërta.</li> <li>• Nota mesatare jo më pak se 2.50 për studentët të cilët janë diplomuar në Bachelor në Universitetin “EPOKA”, mbi 7.00 ose ekuivalente për studentet që janë diplomuar në Bachelor në një Institucion tjetër të Lartë Arsimor.</li> <li>• Niveli i aftësive në gjuhën angleze B2 në një nga provimet e njohura ndërkombëtarisht. Studentët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në anglisht nuk e kanë këtë detyrim.</li> <li>• Studentët që kanë përfunduar studimet Bachelor në Universitetin Epoka me një notë mesatare midis 2.00 - 2.49 ose studentët që kanë përfunduar studimet Bachelor në IAL të tjera me një notë mesatare ndërmjet 6.00 - 6.99 duhet të kalojnë nëpërmjet një interviste në këshillin shkencor në departamentet.</li> </ul> <p>GVJ konfirmon që kriteret janë hartuar përpara fillimit të vitit akademik dhe janë publikuar në faqen e Zyrës së Pranimit.</p> <p>[<a href="https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=master-of-science&amp;catid=1928&amp;menuid=1930">https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=master-of-science&amp;catid=1928&amp;menuid=1930</a>]</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL u informua që Zyra e Pranimit organizon ditët e informimit për studentët që duan të vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve. Ata informohen për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t’u regjistruar. Informacione të zgjeruara mbi programet e studimit janë gjithashtu në dispozicion në internet. Kriteret dhe kërkesat publikohen në faqen e internetit të Zyrës së Pranimit. Informacioni i detajuar mbi kurrikulat e programeve të studimit dhe kurrikulën e Msc në Ekonomiks janë botuar gjithashtu faqen e internetit. Studentët ftohen në kampus përmes rubrikës "Ejani na vizitoni" dhe mund të marrin informacion të detajuar për programe specifike studimi.</p> <p>[Shënime të vizitës në institucion; <a href="http://eis.epoka.edu.al/curricula">http://eis.epoka.edu.al/curricula</a>; <a href="http://eis.epoka.edu.al/curricula/21/program">http://eis.epoka.edu.al/curricula/21/program</a>]</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="549 1704 715 1778"></th> <th data-bbox="715 1704 948 1778">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="948 1704 1179 1778">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1179 1704 1410 1778">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="549 1778 715 1823"></td> <td data-bbox="715 1778 948 1823"></td> <td data-bbox="948 1778 1179 1823"></td> <td data-bbox="1179 1778 1410 1823" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						



**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e programit të studimit të ciklit të dytë. Në nenet 36-37 të kësaj rregulloreje ofrohet informacion i plotë dhe i qartë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Llogaria që studenti ka në sistemin e menaxhimit të informacionit (ESI) i mundëson akses në çdo informacion që lidhet me këto procedura. GVJ e konstatoi këtë edhe gjatë takimeve me studentët dhe personelin akademik.</p> <p><i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", kreu IV; Shënimet e vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni mundëson transferimet brenda universitetit dhe midis universiteteve. Neni 41 i Rregullores Themelore dhe Direktiva "Për transferimin e studentëve" përcakton procedurat, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet për njohjen e studimeve të plota ose të pjesshme të studentëve. Këto procedura mund të aksesohen nga studentët në faqen e IAL-së. Aplikimet për njohje paraqiten në Zyrën e Regjistrimit. Ato shqyrtohen nga departamenti dhe i përcillen Dekanatit të Fakultetit për miratim përfundimtar. Dekanati i Fakultetit analizon kërkesën dhe nëse njohuritë që studenti ka fituar në atë lëndë konsiderohen të mjaftueshme, studenti mund të lirohet nga detyrimi për të ndjekur këtë lëndë.</p> <p><i>[Aneks 5. HEI Regulation, neni 41 <a href="http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation">http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation</a>; <a href="http://epoka.edu.al/mat/directives/13">http://epoka.edu.al/mat/directives/13</a>, ]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloren e programeve të studimit të ciklit të dytë, neni 36-37. Po ashtu syllabusi i çdo lënde ka të përfshirë dhe mënyrën e vlerësimit. Studentët e kanë këtë informacion në sistemin EIS dhe mund ta konsultojnë në çdo kohë.</p> <p>GVJ në takimin me studentët konfirmoi që studentët ishin të informuar mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe kishin akses në sistemin EIS.</p>



	<i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", neni 36-37; Aneks 18.1 Syllabus over year; Shënimet e vizitës në institucion]</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit përcaktohen në rregulloren e programeve të studimit të ciklit të dytë nenet 32-35. Për të mbështetur studentët, institucioni ka përgatitur një udhëzues specifik mbi procesin e punimit të diplomës dhe një format të punimit të diplomës së masterit. Pas përfundimit të diplomimit studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës. <i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", neni 32-35; Aneks 63. Thesis Guideline; Aneks 68. Master Thesis Form; Aneks 14. Diploma Supplement Model]</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Zyra e Pranimit organizon në mënyrë periodike ditë të hapura ku ftohen studentët potencial në kampus për të marrë informacion të detajuar mbi universitetin dhe programe të veçanta studimi. Pas marrjes së informacionit të përgjithshëm nga Zyra e Pranimit, studentët shoqërohen për të marrë informacion më të detajuar mbi programet e veçanta të studimit në departamentin që mbulon programin e studimit. Informacione në lidhje me programin e studimit studentët mund të gjejnë dhe në faqen e programit të studimit apo në faqen e Zyrës së Pranimeve. <i>[<a href="https://admissions.epoka.edu.al/">https://admissions.epoka.edu.al/</a>, <a href="https://eco.epoka.edu.al/home-m-sc-in-economics-310-1253.html">https://eco.epoka.edu.al/home-m-sc-in-economics-310-1253.html</a>]</i>		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve realizohet përmes disa mënyrave si: <ul style="list-style-type: none"> <li>Nga Zyra e Pranimeve</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Statuti dhe rregullorja e programit të studimit</li> <li>• Departamenti përgjegjës që ofron PS.</li> </ul> <p>Studentët që pranohen në programin e studimit informohen gjatë javës të orientimit kryesisht nga koordinatori i programit. Ndërsa informacioni mbi organigramën e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe veprimtarinë e tij, detaje mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqen e institucionit. Gjatë takimit me studentët, drejtuesit e departamentit dhe Zyrën e Pranime GJV konfirmoi marrjen e informacionit nga të gjitha këto burime.</p> <p>[<a href="https://www.epoka.edu.al/home.html">https://www.epoka.edu.al/home.html</a>]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët kanë mundësi të aksesojnë systemin LMS ku gjejnë materiale që lidhen me përmbajtjen e moduleve, syllabuset dhe materiale mësimore. Ndërsa nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit (EIS) ata marrin informacion të nevojshëm në lidhje me lëndët, regjistrimet, orarin dhe notat. Në faqen e internetit të UE publikohet gjithashtu orari mësimor dhe ai i provimeve (timetables). GJV konfirmoi në takimin me studentët që institucioni i ka dhënë akses në këto sisteme dhe ata janë të mirëinformuar mbi të gjitha elementët që lidhen me PS.</p> <p>[<a href="http://epoka.edu.al/home-students-timetables-4-395.html">http://epoka.edu.al/home-students-timetables-4-395.html</a>];  <a href="http://lms.epoka.edu.al/">http://lms.epoka.edu.al/</a>]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi që GJV pati me stafin e Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarëve (CPAO) u informua që kjo zyrë orienton studentët drejt tregut të punës. Çdo student që merr pjesë në aktivitete të zhvillimit të karrierës duhet të regjistrohet pranë zyrës duke ndjekur hapat e përshkruar në Rregulloren e Zyrës së Këshillimit dhe të Karrierës. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarëve informon studentët për praktikatat dhe mundësitë e punësimit. Panairi i Karrierës organizohet çdo vit për të prezantuar tek studentët mundësitë që ofron tregu i punës. Gjithashtu në faqen e Zyrës për Planifikimin e Karrierës publikohen të dhëna mbi mundësitë e intershipeve dhe punësimit.</p> <p>[<a href="https://cpao.epoka.edu.al/home-eighth-career-fair-2021-1593-3013.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=eighth-career-fair-2021&amp;catid=1593&amp;menuid=3013">https://cpao.epoka.edu.al/home-eighth-career-fair-2021-1593-3013.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=eighth-career-fair-2021&amp;catid=1593&amp;menuid=3013</a>; <a href="https://cpao.epoka.edu.al/">https://cpao.epoka.edu.al/</a>]</p>

*Arby* *Elkeq*



<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në javën orientuese studentët informohen nga koordinatori i programit dhe personeli i Zyrës së Regjistrimit mbi mënyrën e organizimit të procesit mësimor, infrastrukturën në funksion të programit të studimit, logjistikën dhe shërbimet mbështetëse që ofron institucioni. Orari mësimor afishohet në faqen e internetit (timetables) dhe studentët informohen lidhur me mjediset që do përdoren, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Përmes guidës orientuese studentët marrin gjithashtu informacion mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që u ofrohen për të realizuar studimet e tyre. [<a href="http://epoka.edu.al/home-students-timetables-4-395.html">http://epoka.edu.al/home-students-timetables-4-395.html</a>]</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Zyra Koordinuese e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit mundëson komunikimin e pedagogëve me studentët nëpërmjet sistemit LMS (Sistemit të Menaxhimit të Mësimimit) dhe e-mail-it me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e informatikës. Studentët mund të futem me email-in e tyre në sistem ku gjejnë të gjithë informacionin personal dhe informacionin që lidhet me programin e studimit. Studentët mund të aksesojnë sistemin dhe nga jashtë institucionit, pasi platforma është webbased. [<a href="http://lms.epoka.edu.al/">http://lms.epoka.edu.al/</a>]</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>GVJ në takimin me studentët dhe personelin akademik konfirmoi që përmes sistemit EIS studentët mund të regjistrojnë lëndët që do të ndjekin, të kontrollojnë pjesëmarrjen, të shohin datat e provimeve, notat e ndërmjetme dhe notat përfundimtare, kurrikulën e programit, transkriptin, kërkesat dhe njoftimet. Gjithashtu përmes këtij sistemi ata plotësojnë dhe pyetësorin e studentit. Ky system iu mundëson studentëve të krijojnë plane individuale për lëndët, që i mundëson ata të diplomohen në kohë. [Shënime të vizitës në institucion]</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

**Standardi V.4**


**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore e cila mban regjistrat ku ka të dhëna në lidhje me studentët e regjistruar në çdo vit akademik (regjistri themeltar), ecurinë akademike (regjistri i notave) dhe regjistri i diplomimit të studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për të gjithë periudhën midis dy akreditimeve ka qënë nën 10 student. Sipas drejtuesve të njësisë bazë dhe njësisë kryesore në këtë trend ka ndikuar numri i ulët i studentëve në programin e ciklit të parë dhe fakti që një pjesë e studentëve zgjedhin të studiojnë jashtë ose në institucione të tjera në ciklin e dytë. Ndërkohë mesatarja në hyrje ka ardhur duke u rritur. Në vitin akademik 2020-2021 mesatarja në hyrje ka qënë 3.23. GVJ kontrolloi regjistrin themeltar të studentëve të regjistruar dhe të transferuar si dhe regjistrin e arritjeve akademike me lëndë të zgjedhura rastësisht dhe konstatoi saktësi në hedhjen e të dhënave nga process verbalet e notave në regjistër.</p> <p>Të dhënat mbi numrin e studentëve raportohen në MAS, publikohen në raportin vjetor të IAL-së dhe dërgohen dhe në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.</p> <p>Sipas (Tabelave përmbledhëse, tabela nr.21) dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarine mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për gjashtë vitet e fundit akademike ishte:</p> <p>Viti 2016-2017 2 studentë gjithsej  Viti 2017-2018 6 studentë gjithsej;  Viti 2018-2019 5 studentë gjithsej;  Viti 2019-2020 8 studentë gjithsej;  Viti 2020-2021 9 studentë gjithsej;  Viti 2021-2022 5 studentë gjithsej.</p> <p>[Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020 shqip, fq. 18-19; Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 21; Shënime të vizitës në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit</p>	<p>UE disponon statistika për numrin e të regjistruarve, tërheqjeve nga programi, largimeve përpara përfundimit të vitit akademik, etj. Numri i studentëve të regjistruar në PS për 6 vitet e fundit akademike është 35 dhe nuk ka asnjë studentë të transferuar. Këto të dhëna janë në regjistrin themeltar dhe ruhen në Sekretarinë e Fakultetit në mënyrë konfidenciale. Numri total i</p>



<p>akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>studentëve të regjistruar, diplomuar dhe të transferuar publikohet në raportin vjetor dhe raportohet në MAS. [Anëks 19: Raporti Vjetor_2019_2020_shqip, fq. 18-19; Anëks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 21; Shënime të vizitës në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi që sekretaria regjistron në regjistrin e notave të gjithë informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Informacioni ruhet gjithashtu online dhe është i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit (EIS). Sekretaria mësimore nëpërmjet sistemit elektronik mund të printojë listën e notave për secilin studentët. Sistemi llogarit gjithashtu mesataren për çdo semestër dhe mesataren e përgjithsme e cila jep informacion të plotë dhe të detajuar mbi performancën e studentëve. [Shënime të vizitës në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme vetëm nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësisive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve (EIS). GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të rregjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe konstatoi që informacioni ishte i saktë dhe i ruajtur sipas procedurave të miratuara. [Shënime të vizitës në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Sekretaria mësimore përgatit raporte në fund të çdo viti akademik ku jepet informacion i detajuar mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për çdo program studimi. Këto të dhëna përdoren nga departamentet për të hartuar raportin vjetor. Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën gjithashtu një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të cilin e përfshin në Raportin Vjetor që dorëzohet në MAS dhe publikohet në faqen e institucionit. Ndërsa punësimi i studentëve gjurmohet nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar. Përmes një pyetësori ato mbledhin të dhëna mbi shkallën e punësimit, sektorin ku janë punësuar dhe pasi përpunohen të dhënat ato bëhen publike në faqen e Zyrës.</p>





	[Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020_shqip, fq. 18-19; <a href="https://docs.google.com/document/d/1zII SAXOj4-xB8-aj5IEPB7XabcRyflru/edit">https://docs.google.com/document/d/1zII SAXOj4-xB8-aj5IEPB7XabcRyflru/edit</a> ; Shënime të vizitës në institucion]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në statutin e UE parashikohet përfaqësimi i e studentëve në disa organe vendimmarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Numri dhe niveli i përfaqësimit është i përcaktuar në statut. Studentët janë të përfaqësuar në organet dhe komisione si më poshtë: Senatin Akademik (2 studentë); Bordin e Etikës (2 studentë); Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (1 studentë); dhe Komisionin e Përherëshëm për Marrëdhëniet Studentore (2 studentë).  [Aneks 2. Statuti Uni EPOKA shqip nenet 15/4, 29/2, 34/2, 35/8]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që IAL është angazhuar maksimalisht në informimin dhe orientimin e studentëve mbi të drejtat dhe përfaqësimin e tyre në strukturat vendimmarrëse të institucionit, për të sjellë shqetësimet e tyre dhe për të ofruar zgjidhje. Gjatë vizitës GVJ konfirmoi gjithashtu se Këshilli Studentor funksionon dhe antarët e tij përçojnë shqetësimet e studentëve në të gjitha trupat vendimmarrëse. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorëve; është një proces i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe është një instrument që ka ndihmuar në përmirësimin e programeve të studimit dhe adresimin më të mirë të nevojave dhe shqetë simeve të studentëve.  [Aneks 2. Statuti Uni EPOKA shqip nenet 15/4, 29/2, 34/2, 35/8; Aneks 22. Student Satisfaction Survey]



<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë paraësh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Sipas planit mësimor studentët duhet të ndjekin 4 lëndë çdo semestër dhe kanë 12 orë në javë në auditor- Numri total i orëve për të gjithë programin e studimit është 1500 orë. GVJ konstatoi se programi i studimit është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe duke zbatuar aktet ligjore në fuqi për orët në auditor dhe studimin individual. Statuti dhe rregullorja parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme, mobilitetet e studentëve si dhe ripranimin në programin e studimit.</p> <p><i>[Aneks 2. Statuti_Uni EPOKA_shqip; Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs"; Aneks-Tabelat Përmbledhëse]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja reale e studentëve, në organe këshilluese dhe vendimarrëse, ka mundësuar tërheqjen e mendimit të studentëve mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që pyetësori si një instrument i drejtpërdrejtë për tërheqjen e mendimit të studentëve plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri. Pyetësori menaxhohet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe analiza e rezultateve i shkon Rektorit, i cili përcjellë gjetjet e pyetësorit në Departament dhe urdhëron të përpilohet plani i masave përkatëse. GVJ konstatoi që ky proces kryehet perodikisht mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni dhe takimit me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>[Shënime të vizitës në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësies/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Rregullorja mbi programet e studimit të ciklit të dytë, si dhe udhëzimi mbi provimet mundëson barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimit, rishikimit dhe përmirësimit të rezultateve të provimit studentëve si dhe përcakton procedurën që duhet të ndiqet nga institucioni në çdo rast. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që studentët kanë akses në këtë informacion dhe u konfirmua gjatë takimit me studentët, që kjo e drejtë e tyre ishte plotësuar në rast nevoje.</p> <p><i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs", Shënime të vizitës në institucion]</i></p>			
	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="686 1825 925 1892">Përbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="925 1825 1165 1892">Përbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1165 1825 1426 1892">Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		



Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

**Standardi V.6**

**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	GVJ përmes takimit që pati me personelin akademik dhe mbështetur në dokumenta si raporti vjetor i departamentit, raporti vjetor i institucionit dhe CV-të konstatoi që personeli i angazhuar në programin e studimit Msc në Ekonomiks ka marr pjesë në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare, të organizuara nga vet institucioni apo institucione të tjera. Sipas raportit vjetor në vitin akademik 2019-2020 personeli akademik i UE ka marr pjesë në 18 konferenca shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. UE jep gjithashtu mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit në konferenca shkencore. [Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020 shqip, fq. 4; Aneks 20. Department Annual Report, fq.48-49; <a href="https://eco.epoka.edu.al/home-scientific-conference-1110-2473.html">https://eco.epoka.edu.al/home-scientific-conference-1110-2473.html</a> ]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	UE ka marrëveshje partneriteti me mbi 80 Universitete. Natyra e marrëveshjeve është memorandume mirëkuptimi dhe bashkëpunime në kuadër të projekteve si: K-FORCE, Erasmus+ KA1, KA2 PANBioRA, HORIZON 2020, etj. Universitetet partnere janë kryesisht në vende të BE, SHBA dhe në rajonin e Ballkanit. Përmes projekteve janë realizuar mobilitete të stafit dhe studentëve, por ka dhe projekte që kanë patur si synim realizimin e studimeve apo kërkimeve të përbashkëta. Departamenti i Ekonomiksit është partnerë në tre projekte të financuara nga Programi i Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studime Universitare (CEEPUS). [Aneks 20. Department Annual Report, fq. 48; <a href="https://epoka.edu.al/membership/cat-partnerships-2322.html">https://epoka.edu.al/membership/cat-partnerships-2322.html</a> ; <a href="https://www.ceepus.info/content/find#nbb">https://www.ceepus.info/content/find#nbb</a> ]
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe kryesisht në takimet me studentët konstatoi që personeli akademik i ka nxitur studentët e ciklit të dytë dhe të tretë të bëhen pjesë e studimeve apo punëve të tyre kërkimore. Studentët mund t'i paraqesin punimet e tyre në



	<p>konferencën e studentëve, në Klubin e Ekonomistëve të Rinj ose duke i publikuar ato si punime të përbashkëta me pedagogët udhëheqës.</p> <p>[Aneks 20. Department Annual Report, fq. 48; Shënime të vizitës në institucion]</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Bordi i Administrimit të UE ka miratuar një politikë që mbështet financiarisht publikimin e artikujve në revista ndërkombëtare me faktor impakti si dhe të rankuara në Scopus/Thomson Reuters. GVJ e konfirmoi zbatimin e kësaj politike në disa nga takimet që pati gjatë vizitës në institucion ku antarë të stafit pohonin se kishin përfituar mbështetje për publikimet e tyre.</p> <p>[Shënime të vizitës në institucion]</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>GVJ në takimin me studentët e programit të studimit konfirmoi që studentët janë inkurajuar në vazhdimësi nga personeli akademik për tu përfshirë në projektet e tyre studimore dhe për të publikuar punimet e tyre në konferenca apo revista shkencore. Mjedisi në department është gjithashtu mbështetës për përfshirjen e studentëve në projekte. GVJ konstatoi që megjithë mjedisin stimulus rezultati është modest për shkak të numrit të vogël të studentëve në këtë program studimi.</p> <p>[Aneks 20. Department Annual Report, fq. 48; Shënime të vizitës në institucion]</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Ekonomiksit është i organizuar në tetë grupe kërkimore. Studentët e programit të ciklit të dytë drejtohen në punimin e diplomës nga personeli akademik që mbulon programi i studimit. Studentët janë drejtuar në diplomat e tyre nga personel akademik me përvojë. GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi që studentët kanë patur mbështetjen e drejtuesve të diplomës për të analizuar të dhënat dhe formuluar rezultatet e kërkimit.</p> <p>[Aneks 20. Department Annual Report, fq. 43-44; Aneks 48. Department Research Areas; Shënime të vizitës në institucion]</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>		
	<p>Përmbushet kryesisht</p>		
	<p>Përmbushet plotësisht</p>		
			<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.7</b>  <b>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Arby* *Esliq*



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UE ka bashkëpunim me një pjesë të madhe të universiteteve shqiptare me të cilat ka memorandume mirëkuptimi apo janë partnere në zbatimin e projekteve të financuara me fonde të BE-së. Zbatimi i këtyre projekteve dhe ndërveprimi me kolegë të IAL-ve të tjera i shërben arritjes së objektivave të PS. Institucioni ka gjithashtu marrëveshje mirëkuptimi me rreth 70 institucione jo arsimore me të cilat bashkëpunon për të realizuar paktikat e studentëve, apo për të afruar studentët me tregun e punës. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që UE ka bashkëpunime me organizma të ndryshme arsimore dhe joarsimore dhe kjo reflektohet në numrin e madh të projekteve ku ajo është partnere. [<a href="https://projects.epoka.edu.al/home-erasmus-2359-1176.html">https://projects.epoka.edu.al/home-erasmus-2359-1176.html</a>; <a href="https://epoka.edu.al/membership/cat-partnerships-2322.html">https://epoka.edu.al/membership/cat-partnerships-2322.html</a>]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i PS përmban disa lëndë të cilat i pajisin studentët me njohuri që mund të aplikohen në ciklin e tretë të studimeve siç janë: Seritë kohore në Ekonometri, Mikroekonomi dhe Makroekonomi e aplikuar, etj. Në planin mësimor metodat e kërkimit kanë një vend të rëndësishëm. GVJ në takimin me studentët konstatoi që të gjithë studentët donin të vazhdonin ciklin e tretë për ekonomiks dhe programi studimit siguron vijueshmëri dhe i përgatit studentët për këtë program. [Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 10; Shënime të vizitës në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Institucioni është përfshirë në shumë projekte me institucione arsimore ndërkombëtare, çka mundëson përfshirjen e stafit në mobilitete apo projekte kërkimore. Sipas të dhënave në periudhën midis dy akreditimeve janë realizuar 19 mobilitete nga stafi i Njësisë kryesore, midis të cilëve ka dhe studiues të rinj. Ndërsa numri i mobiliteteve për studentët është i ulët. Këtu ka ndikuar dhe situata e pandemisë në dy vitet e fundit. Institucioni e mbështet personelin akademik që të përfshihet në punë kërkimore dhe për ta mundësuar këtë kërkuesve të rinj iu vihet në dispozicion një buxhet vjetor për 3 vite rresht që të marrin pjesë në konferenca ndërkombëtare apo për të publikuar punimet e tyre në revista ndërkombëtare. [Aneks 58. Student and staff mobilities table; Shënime të vizitës në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Kërkimi shkencor dhe ndërkombëtarizimi janë prioritet të UE. Për të arritur objektivat në këtë fushë Universiteti nxit mobilitetin e stafit dhe mirëpret studiues të huaj në kuadër të mobiliteteve të mbështetura nga programi Erasmus+, në kuadër të projekteve</p>

*Bule* *E. Stafa*



	apo si vizitor për leksione të hapura. Në periudhën midis dy akreditimeve Njësia kryesore ka pritur 8 kërkues të huaj. Në këtë numër ka ndikuar dhe situata e pandemisë. <i>[Aneks 58. Student and staff mobilities table; Shënime të vizitës në institucion]</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Gjatë takimit me studentët GVJ konstatoi që UE lehtëson përmes Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare mobilitetin e studentëve në kuadër të projekteve Erasmus+ dhe projekte të tjera. Informacionet për tu bërë përfitues janë të publikuara në faqen e UE dhe mund të aksesohen lehtësisht nga studentët. <i>[Aneks 58. Student and staff mobilities table; Shënime të vizitës në institucion; https://iro.epoka.edu.al/]</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	UE mirëpret studiues të huaj në kuadër të mobiliteteve të mbështetura nga programi Erasmus+, në kuadër të projekteve apo si vizitor për leksione të hapura. Në periudhën 2020-2021 Departamenti Ekonomiksit ka realizuar 10 leksione të hapura, seminare dhe workshope me pjesëmarrjen e kërkuesve të huaj. Ndërsa numri i mobiliteteve ka qënë 8 në periudhën midis dy akreditimeve nga kërkuesit e huaj. Menaxhimi i këtyre aktiviteteve lehtësohet nga Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Zyra e Kërkimeve dhe Projekteve në bashkëpunim me Njësitë kryesore. GVJ konstatoi që Njësia bazë ka eksperiencë në veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie me institucione ndërkombëtare dhe një përfshirje të mirë në projekte dhe aktivitete me kërkuesit dhe studentët e huaj. <i>[Aneks 58. Student and staff mobilities table; Shënime të vizitës në institucion; https://iro.epoka.edu.al/]</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	UE ka krijuar strukturën e zyrës së Dekanit të Studentëve, e cila u siguron studentëve mbështetjen, burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet. Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<p>lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Dekani i studentëve pranon kërkesat e tyre çdo ditë dhe kërkesat vlerësohen nga strukturat përkatëse. Zyra e dekanit të studentëve informon me e-mail studentët për vendimin në lidhje me kërkesën e tyre.</p> <p>[Aneks 2. Statuti Uni EPOKA shqip: <a href="http://dos.epoka.edu.al/cat-about-us-549.html">http://dos.epoka.edu.al/cat-about-us-549.html</a>]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, siç janë Zyra e Regjistrimit, Koordinator i Programit, Zyra e Pranimeve, Zyra e Koordinimit të Studentëve dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar. Rregulloret e institucionit parashikojnë pjesëmarrjen e studentëve në organet vendimarrëse, këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies në mënyrë që ata të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Drejtoritë në shërbim të studentit organizojnë aktivitete si ditët e orientimit, panairët e punës, dhe fushatat e informimit për të promovuar shërbimet e tyre. Zyra e Regjistrimit pajis studentët me Udhëzuesin e Studentit që përmban informacione të hollësishme për jetën e studentit, nga regjistrimi deri në diplomim</p> <p>[Aneks 9. 2020-2021 Smart Student Guide]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të diplomuar GVJ u informua që zyra ofron shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen. Roli i saj konsiston në informimin e studentëve mbi mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.</p> <p>[<a href="https://cpao.epoka.edu.al/">https://cpao.epoka.edu.al/</a>; Shënimet e vizitës në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar ka si detyrë gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo disponon një bazë të dhënash mbi studentët e diplomuar në këtë institucion. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që zyra zhvillon çdo vit vrojtimin me studentët e diplomuar dhe</p>



	rezultatet i vihen në dispozicion departamenteve dhe publikohen në faqen zyrtare të Zyrës.  [ <a href="https://cpao.epoka.edu.al/cat-alumni-survey-3071.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=alumni-survey&amp;catid=3071&amp;menuid=3071">https://cpao.epoka.edu.al/cat-alumni-survey-3071.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=alumni-survey&amp;catid=3071&amp;menuid=3071</a> ]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Statuti i IAL-së parashikon ngritjen e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional në nenin 14 të tij, neni 35 përcakton detyrat e komisionit, ndërsa nenet 37-38 strukturën dhe kompetencat e Zyrës për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. IAL ka miratuar gjithashtu Politikën e Cilësisë që përmban parimet dhe standardet kryesore të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Në faqen e internetit të IAL-së është i publikuar i gjithë informacioni në lidhje me politikën, strukturat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludoi që UE ka miratuar politika dhe procedura, si dhe ka ngritur strukturat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të cilat funksionojnë në përputhje me statutin, rregulloret dhe aktet e tjera të miratuara nga institucioni dhe në



	rezultatet i vihen në dispozicion departamenteve dhe publikohen në faqen zyrtare të Zyrës.  [https://cpao.epoka.edu.al/cat-alumni-survey-3071.html?lang=EN&dpid=2&t=alumni-survey&catid=3071&menuid=3071]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Statuti i IAL-së parashikon ngritjen e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional në nenin 14 të tij , neni 35 përcakton detyrat e komisionit, ndërsa nenet 37-38 strukturën dhe kompetencat e Zyrës për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. IAL ka miratuar gjithashtu Politikën e Cilësisë që përmban parimet dhe standardet kryesore të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Në faqen e internetit të IAL-së është i publikuar i gjithë informacioni në lidhje me politikat, strukturat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludoi që UE ka miratuar politika dhe procedura, si dhe ka ngritur strukturat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të cilat funksionojnë në përputhje me statutin, rregulloret dhe aktet e tjera të miratuara nga institucioni dhe në

*[Handwritten signatures]*



	<p>përmbushje të kërkesave të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë në RSH".</p> <p>[Annex 2. The Statute of HEI; Annex 7. Regulation of EPOKA University "On the Organization and Functioning of the PCQA"; Aneks 8. Directive of EPOKA University "On Academic and Administrative Assessment and Quality Improvement"; <u>Aneks 33. Quality Policy</u> ; <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html">http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html</a>; Aneks 34. Directive -On the Fuctioning of the Exam Board]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sistemi i sigurimit të cilësisë në UE përfshin NJSBC dhe KSBC, rregulloret, procedurat, udhëzimet dhe instrumentat e sigurimit të cilësisë. Ngritja dhe funksionimi i strukturave është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas neneve të parashikuara në statut, i cili monitorohet nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Komisionit të Përhershëm në nivel Institucioni dhe auditit të brendshëm. Në NJSBC përfshihet personel administrativ i cili ndjek procedurat për sigurimin e cilësisë dhe ka karakter kryesisht administrativ dhe procedural. Stafi miratohet me propozim të Rektorit nga Senati Akademik. Roli i Njësisë (Zyrës) përfshin vlerësimin periodikë të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në njësitë kryesore të Universitetit, kryen studime eksploruese për të vlerësuar punësimin e studentëve dhe efektivitetin e programeve të ofruara nga Universiteti, si dhe organizon pyetësorin e studentëve për cilësinë e lëndëve mësimore për secilin program studimi. Njësia varet dhe raporton në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Komisioni përbëhet nga 12 antarë, nga të cilët një është student, një ish student dhe një ekspert i jashtëm. GVJ konstatoi se sistemi i sigurimit të cilësisë është i ngritur dhe funksion në mënyrë të efektshme.</p> <p>[Annex 2. The Statute of HEI; Annex 7. Regulation of EPOKA University "On the Organization and Functioning of the PCQA"; Aneks 8. Directive of EPOKA University "On Academic and Administrative Assessment and Quality Improvement"; <u>Aneks 33. Quality Policy</u> ; <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html">http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html</a>; Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 24]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve</p>	<p>NJSBC përdor instrumenta të ndryshme për vlerësimin periodik të mësimdhënies, mësimnxënies, veprimtarive kërkimore, kënaqësisë së studentëve dhe shërbimeve për mbështetjen e tyre. Vlerësimet periodike të realizuara nga NJSBC bëhen pjesë e</p>



<p>analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>raportit vjetor të institucionit. IAL i është nënshtruar vlerësimit institucional tre herë dhe ka marr vlerësim pozitiv. Gjithashtu të gjitha programet e studimit i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm. PS "Msc në Ekonomiks" po kalon procesin e akreditimit për here të dytë. Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm janë të publikuara në faqen e institucionit. GVJ konstatoi që IAL përdor instrumentat e duhur për sigurimin e cilësisë dhe ky proces realizohet me përfshirjen e të gjitha strukturave.</p> <p><i>[<a href="http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html">http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html</a>; <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html">http://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html</a>]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato ënojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>UE ka si objektiv sigurimin e cilësisë në nivel institucional, në njësitë përbërëse dhe tek të gjithë aktorët e brendshëm institucional. Arritjes së objektivit i shërben politika e cilësisë, politika për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve mësimore dhe manuali për sigurimin e cilësisë. Krahas procedurave të akreditimit për të siguruar cilësinë e programve IAL vlerëson çdo vit performancën e programeve të studimit mbështetur në treguesit e cilësisë për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, rishikon dhe përmirëson ato duke marr në konsideratë nevojat e tregut të punës, opinionet e marra nga studentët dhe grupi i të diplomuarëve, vlerëson mësimdhënien dhe rezultatet e të nxënit. GVJ gjykon se të gjitha përpjekjet e institucionit dhe instrumentat e ndryshëm që përdor i shërbejnë krijimit të kulturës së cilësisë në nivel institucioni. NJSBC në çdo rast është prezent për të siguruar cilësinë, për të krijuar këtë kulturë dhe për të bërë procesin transparent.</p> <p><i>[Aneks 7. Regulation of EPOKA University "On the Organization and Functioning of the PCQA"; Aneks 33-Quality Policy; 38. EPOKA Quality Assurance Handbook]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.2**  
**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të ënuara të të nxënit.**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në statutin e UE, Departamenti Ekonomiksit është përgjegjës për mirëfunksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njësia bazë monitoron dhe rishikon programet e studimit, mbështetur në Politikën për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit. Propozimet e departamentit për përmirësimin e kurrikulës diskutohen fillimisht në Dekanat. Propozimi i miratuar nga Dekanati për përmirësimin e programit të studimit i dërgohet Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave, dhe më pas propozimi dërgohet në Komisionin e Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë. Senati Akademik merr vendimin përfundimtar në lidhje me përmirësimin e programit të studimit mbështetur në rekomandimet e komisioneve. GVJ konstatoi që NJSBC dhe të dy komisionet bashkëpunojnë me Departamentin dhe Dekanatin për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p> <p><i>[Aneks 2: 2. The Statute of HEI, neni 12; Aneks 12. Policy of EPOKA University "On Continuous Improvement of Study Program"; Aneks 31. Curriculum change procedure]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit, si njësia bazë e menaxhimit të programit të studimit propozon ndryshimet në kurrikulën e programit. Departamenti i paraqet propozimet për ndryshime në Dekanat. Vendimi i Dekanatis i përcillet Komisionit të Kurrikulave. Mendimi i këtij komisioni i përcillet KPSC dhe raporti i KPSC kalon në Senatin Akademik për vendimin përfundimtar. Për këtë qëllim IAL ka miratuar një rregullore të veçantë për PS të ciklit të dytë, si dhe politikën për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Rishikimet e këtij programi studimi janë realizuar kryesisht në plotësim të kërkesave ligjore, por edhe duke vërejtur nevoja të ndryshme për shtimin apo heqjen e lëndëve dhe ndryshimin e ECTS. Në vitin akademik 2016-2017 është ndryshuar numri i krediteve për të gjitha lëndët nga 6 ECTS në 7.5 ECTS. Numri i orëve në auditor është lënë i njëjtë, ndërkohë që është rritur numri i orëve për studim individual me 36.7%. Ndryshimet janë përcjellë me procedurë në Rektorat dhe Senat. Të gjitha hallkat e ndjekura në këtë proces janë të dokumentuara dhe formalizuara.</p> <p><i>Megjithatë sipas Evidencave rezulon që për programin në fjalë nuk janë kryer përshtatjet sipas kërkesave të VKM nr. 41, datë 24.01.2018 për Planin mësimor sipas veprimtarive formuese. Mikroteza është parashikuar me 30 ECTS, ndërkohë që sipas VKM-së detyrimet përmbyllëse duhet të zënë maksimumi 15% ose 18</i></p>

*Becky* *E. Steby*



	<p><i>ECTS. Në planin mësimor nuk është përfshirë praktika profesionale tek lëndët plotësuese.</i></p> <p><i>[Aneks 6. Regulation of EPOKA University "Regulation on Second Cycle Study Programs"; Aneks 12. Policy of EPOKA University "On Continuous Improvement of Study Program"; 31. Curriculum change procedure; Aneks-Tabelat Përmbledhëse, tabela 9 dhe tabela 11]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Metodologjia e vlerësimit për programet e studimit është përcaktuar tek Politikat për Përmirësimin e Vazhdueshëm të PS. Disa nga instrumentat e përdorura nga IAL për të vlerësuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyetësorët me studentët, të cilat plotësohen në fund të çdo semestri. Studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe përmbajtjen e lëndës. Rezultatet e marra nga vlerësimet e studentëve janë një element i rëndësishëm për të vlerësuar progresin e PS;</li> <li>• Forma e vlerësimit të provimeve;</li> <li>• Pyetësori me studentët për kënaqësinë e shërbimeve;</li> <li>• Raporti i departamentit për rezultatet përfundimtare të studentëve për të gjitha lëndët;</li> <li>• Raporti mbi cilësinë e provimeve dhe korigjimeve përgatitur nga Bordi i Provimeve. Raporti iu shpërndahet të gjitha njësive përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve të ngritura;</li> <li>• Raporti Vjetor i cili përfshin informacione dhe analiza mbi treguesit kryesorë të performancës së programeve të studimit, siç është niveli i diplomimit të studentëve, shkalla e kalimit të studentëve për të matur rezultatet e të nxënit;</li> <li>• Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe planet e veprimit për të ndjekur rekomandimet e mbetura nga akreditimi i mëparshëm;</li> <li>• Vlerësimi i Performancës Akademike në Mësimdhënie, Kërkim dhe Projekte sipas Direktivës për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë;</li> <li>• Krijimi i bazës së të dhënave të vlerësimit të departamentit për secilin program studimi, i cili përfshin informacionin e treguesve kryesorë të performancës për secilin program studimi dhe ia dërgon Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.</li> </ul>



	<p>[Aneks 8. Directive of EPOKA University "On Academic and Administrative Assessment and Quality Improvement"; Aneks 21. Course Instructor Evaluation Survey; Aneks 36. Exam assessment Form; Aneks 22. Student Satisfaction Survey; Aneks 23. Alumni Survey Form; Shënimet gjatë vizitës; <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html">http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html</a>; <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html">http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html</a>]</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e instrumentave monitorues dhe vlerësues përpunohen nga strukturat përgjegjëse dhe përmbledhen në formën e raporteve si raporti i departamentit, raporti vjetor, studimi në lidhje me ish studentët (Alumni). UE ka një sistem (Sistemi Interaktiv Epoka) ku janë depozituar opinionet e studenëtëve. Vlerësimet janë të agreguara dhe mund të shihen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit. Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe gjatë vizitave në IAL GVJ konstatoi që rezultatet e vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse dhe vendimmarrëse për PS. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë të publikuara në faqen e IAL.</p> <p>[Aneks 16. Alumni Survey; Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020 shqip; <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html">http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html</a>; <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html">http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html</a>]</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësisë dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi që në raportet vjetore përfshihen rezultatet e pritshme të vlerësimit dhe rezultatet e arritura. Ndërsa për të adresuar mangësitë hartohen plane veprimi të veçanta ku pasqyrohen rekomandimet, masat që duhen marrë dhe progresi që është bërë. Për këtë program studimi nuk janë lënë rekomandime nga akreditimi i parë.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me</p>	<p>Departamenti Ekonomiksit, që është përgjegjës për programin e studimit nën shqyrtim, ka kryer dy vlerësime të brendshme për këtë program studimi (ky raport është i dyti). Në të gjithë këtë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>proces departamenti është mbështetur nga NJSBC. Rezultatet e mëparshme të vetëvlerësimit janë përfshirë në raportet e vlerësimit institucional. Departamenti realizon gjithashtu në mënyrë periodike analizë të punës mësimore dhe shkencore të stafit akademik që mbulon programin e studimit dhe publikon një raport vjetor. Në faqen e departamentit janë të publikuara raportet vjetore që nga viti akademik 2013-2014. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që vlerësimi i programit është kryer në mënyrë periodike dhe informacioni është përfshirë në raportin e vetëvlerësimit institucional.</p> <p><i>[<a href="https://eco.epoka.edu.al/">https://eco.epoka.edu.al/</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>IAL përdor metoda dhe instrumenta të ndryshëm si: pyetësi për kursin/instruktorin; pyetësi për kënaqësinë me stafin akademik, pyetësi për kënaqësinë e studentëve me shërbimet, pyetësi me alumni, forma për vlerësimin periodik të provimeve, pyetësi për vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimi i publikimeve dhe aktivitetit akademik për kryerjen e vlerësimit. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që instrumentat e përdorur i përshtaten fushës akademike të programit të studimit dhe përdoren periodikisht nga IAL.</p> <p><i>[Aneks 38. EPOKA Quality Assurance Handbook]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>IAL përdor disa metoda të drejtëpërdrejta si: vlerësimi i cilësisë së provimeve, vëzhgimet në auditor nga titullarët e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, rishikimi periodik i programit, vlerësimi i arritjeve në mësimdhënie, vlerësimi i arritjeve të studentëve për të realizuar vlerësimin e PS. GVJ konstatoi që IAL përdor metoda të drejtëpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të hartimit dhe korigjimit të provimeve, rishikimin e kurrikulës, etj. Këto metoda përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese.</p> <p><i>[Aneks 33-Quality Policy; Aneks 37: Examination Period Assessment Form; Aneks 34. Directive "On the Functioning of the Exam Board"; Aneks 12. Policy of EPOKA University "On Continuous Improvement of Study Program"]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të</p>	<p>UE përdor disa instrumenta të tërthortë për të vlerësuar cilësinë e PS si pyetësin për kursin/instruktorin; pyetësi për kënaqësinë me stafin akademik, pyetësi për kënaqësinë e studentëve me shërbimet, pyetësi me alumni, pyetësi për vlerësimin e provimeve, pyetësi mbi kënaqësinë e kompanive. Kështu</p>



<p>diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>vlerësimi i pedagogëve bëhet në fund të çdo semestri, nga llogaria personale e studentëve, përpara fillimit të provimeve. Departamenti përgatit raport mbështetur në rezultatet e anketimit. Anketimi ka pyetje në lidhje me përmbajtjen e lëndës, metodat e mësimdhënies, performancën e pedagogut të lëndës dhe stafit ndihmës, shërbimet e ofruara nga universiteti si dhe rekomandimet e studentëve. Rezultatet e të gjitha anketave përpunohen dhe i shërbejnë vlerësimit të mbarëvajtjes së PS. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe takimet në IAL konstatoi që këto instrumenta përdoren periodikisht dhe i kanë shërbyer përmirësimit të cilësisë të PS.</p> <p><i>[Aneks 21: Course Instructor Evaluation Survey; Aneks 22: Student Satisfaction Survey; Aneks 16: Alumni Survey; Aneks 62: Teaching Evaluation Form; Shënimet gjatë vizitës]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UE ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë ku përfshihen KPSC, NJSBC, Departamentet dhe Fakulteti, duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. KPSC përbëhet nga 11 anëtarë, nga të cilët një anëtar i stafit akademik me kohë të plotë nga çdo njësi kryesore me të paktën gradën shkencore Doktor dhe i paangazhuar në detyra të nivelit të lartë, një anëtar i stafit administrativ, një përfaqësues i të diplomuarve të Universitetit, si dhe një specialist të jashtëm me përvojë në çështje të sigurimit të cilësisë. Këta janë zgjedhur nga Senati Akademik, për një periudhë dy vjeçare, me të drejtë riemërimi. Nënkryetari i Këshillit Studentor për çështje të sigurimit të cilësisë është gjithashtu anëtar i Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. Katër antarë janë duke ushtruar mandatin e tyre të dytë. Për të garantuar cilësinë UE ka ngritur dhe disa struktura të tjera si Bordi i Provimeve, Bordi i Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të Cilësisë (ngritur</p>



	<p>në vitin akademik 2020-2021) të cilat funksionojnë nën KPSC, janë të zgjedhur nga Senati Akademik dhe realizojnë detyra të përcaktuara.</p> <p><i>[Aneks 2: The Statute of HEI, neni 15 dhe 35; Shënimet gjatë vizitës; Aneks 7. Regulation of EPOKA University "On the Organization and Functioning of the PCQA"; Aneks 34. Directive On the Functioning of the Exam Board; <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/cat-permanent-commission-on-quality-assurance-1408.html">http://aeqi.epoka.edu.al/cat-permanent-commission-on-quality-assurance-1408.html</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga IAL dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi që strukturat që shërbejnë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Në statutin e UE specifikohen qartë mënyra e krijimit të këtyre organeve, funksionet kryesore, mandati i antarëve në komision, vendimmarrja dhe njësitë e tjera me të cilat ato ndërveprojnë. GVJ konstatoi që detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>[Aneks 2: The Statute of HEI, nenet 11, 12, 15, 35, 37 dhe 38; Shënimet gjatë vizitës]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion dhe gjatë vizitës në IAL, GVJ konfirmoi që në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Msc në "Ekonomiks" janë përfshirë Fakulteti, Departamenti i Ekonomiksit, antarët e personelit akademik përmes instrumentave të ndryshme të vlerësimit të brendshëm, NJSBC, studentët e diplomuar dhe studentët nëpërmjet pyetësorëve.</p> <p><i>[Aneks 21: Course Instructor Evaluation Survey; Aneks 22: Student Satisfaction Survey; Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020_shqip; Aneks 16: Alumni Survey; Aneks 62: Teaching Evaluation Form; Shënimet gjatë vizitës]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i venë në dispozicion dhe takimet e zhvilluara me titullarët, stafin akademik, NJSBC dhe studentët u konstatua se të gjithë aktorët janë përfshirë në proces në mënyrë të pavarur, kanë dhënë mendimet dhe kontributin e tyre përmes përdorimit të instrumentave të ndryshëm. GVJ konstatoi që është respektuar integriteti akademik i stafit dhe privatësia e të dhënave të studentëve gjatë gjithë procesit dhe</p>



	nuk u identifikua ndonjë rast diskriminimi apo pabarazi. [Aneks 21. Course Instructor Evaluation Survey; Aneks 22. Student Satisfaction Survey; Aneks 62: Teaching Evaluation Form Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020_shqip]		
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Në Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë përfshihet një anëtar/ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga Alumni. Duke ju referuar RVB dhe dokumentacionit, GVK konstatoi që institucioni ka mundur të bëjë pjesë të proceseve të vlerësimit aktorë të jashtëm nëpërmjet përfshirjes në KPSC dhe zbatimit të instrumentave të ndryshme të vlerësimit si pyetëtori me ish të diplomuarit dhe pyetëtori i kënaqësisë së kompanive përmes të cilave institucioni merr vlerësime që lidhen me arritjet e institucionit në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, komente se si mund të orientohen më mirë dijet që marrin studentën me veprimtarinë praktike dhe rekomandime për përmirësimin e programeve të studimit.  [ <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/cat-permanent-commission-on-quality-assurance-1408.html">http://aeqi.epoka.edu.al/cat-permanent-commission-on-quality-assurance-1408.html</a> ; Aneks 16. Alumni Survey; Aneks 23. Alumni Survey Form; 51. Company Satisfaction Survey]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të ënojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	IAL ka të publikuara në faqen e internetit të gjitha dokumentet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë si: politikën e cilësisë, manualin për sigurimin e cilësisë, rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e KPSC, politikën për përmirësimin e vazhdueshëm të PS, rregulloren mbi funksionimin e bordit të provimeve. Gjithashtu në faqen që lidhet me NJSBC është publikuar përbërja e KPSC, bordit të provimeve, antarët e auditit të brendshëm, si dhe të gjitha raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm (institucional dhe për çdo program studimi), dhe raportet vjetore të IAL. Ndërsa në faqen e departamentit janë të publikuara raportet vjetore të



	<p>departamentit. GVJ konfirmoi që IAL mundëson transparencë maksimale për të gjitha procedurat dhe proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>[<a href="https://aeqi.epoka.edu.al/home.html">https://aeqi.epoka.edu.al/home.html</a>; <a href="https://eco.epoka.edu.al/">https://eco.epoka.edu.al/</a>]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Programi në fjalë është në akreditim periodik. Akreditimi i parë është bërë në vitin 2016. RVB dhe RVJ janë të publikuara në faqen e IAL. Gjithashtu IAL bën publike për stafin dhe studentët rezultatet e pyetësoreve duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale. Personat e interesuar njihen me këto raporte përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të dokumentave.</p> <p>[<a href="https://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-of-ascal-1479-1481.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=external-evaluation-reports-of-ascal&amp;catid=1479&amp;menuid=1481">https://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-of-ascal-1479-1481.html?lang=EN&amp;dpid=2&amp;t=external-evaluation-reports-of-ascal&amp;catid=1479&amp;menuid=1481</a>: Shënimet gjatë vizitës]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit nuk ka patur rekomandime për akreditimin e parë. Ndërsa IAL ka hartuar plane masash për të adresuar rekomandimet e Bordit të Akreditimit në kuadër të vlerësimit të jashtëm për akreditimin institucional apo programet e tjera të studimit. Rekomandimet dhe statusi i plotësimit të tyre janë të publikura në faqen e internetit të IAL/NJSBC. Njësitë administrative dhe ato akademike përgatisin gjithashtu plane veprimi në përgjigje të gjetjeve të auditit të brendshëm të Universitetit.</p> <p>[Shënimet gjatë vizitës në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJSBC analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Vlerësimi realizohet në bashkëpunim me Departamentet, Njësitë kryesore dhe Njësitë ndihmës akademike në nivel institucioni. Raportet periodike të vlerësimit janë raportet vjetore mbi veprimtarinë e departamentit dhe raportit vjetor i IAL që dorëzohet në MASR. Raportet diskutohen në strukturat vendimmarrëse përpara se të publikohen dhe miratohen prej tyre. Raporti vjetor i IAL përmban dhe informacion mbi akreditimin institucional dhe akreditimin e PS. Institucioni ka publikuar gjithashtu një raport vjetor mbi aktivitetin e zhvilluar për sigurimin e cilësisë për periudhën 2020-2021 ku është analizuar ecuria e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara, instrumentat që janë përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe janë identifikuar praktika të mira.</p>



	[Aneks 19. Raporti Vjetor 2019_2020_shqip, fq.42-44; 20. Department Annual Report; Shënimet gjatë vizitës; <a href="https://epoka.edu.al/mat/iqao/2020-2021-Annual-report-of-PCQA">https://epoka.edu.al/mat/iqao/2020-2021-Annual-report-of-PCQA</a> ]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	<p>NJSBC ka organizuar në mënyrë periodike sesione informuese me stafin dhe studentët për problemet e sigurimit të cilësisë në bashkëpunim me Njësitë Kryesore. Studentët dhe stafi kanë gjithashtu në dispozicion manualin e sigurimit të cilësisë dhe udhëzuesin e studentit, përmes të cilave marrin informacion mbi politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni.</p> <p>Disa nga veprimtaritë që IAL ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit kanë qenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfshirja e stafit dhe studentëve në strukturat e SBC;</li> <li>• Përfshirja e stafit në proceset e vlerësimit të brendshëm;</li> <li>• Përfshirja e stafit akademik në vlerësimin e performancës;</li> <li>• Informimi i studentëve mbi rëndësinë e vlerësimit të kurrikulës/pedagogut për përmirësimin e programit të studimit;</li> <li>• Përfshirja e studentëve në pilotimin e pyetësorëve dhe grupet e vlerësimit të brendshëm.</li> </ul> <p>[Aneks 33: Quality Policy; Shënimet gjatë vizitës në institucion]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbyhet plotësisht</b>	<b>Përmbyhet kryesisht</b>	<b>Përmbyhet pjesërisht</b>	<b>Përmbyhet jo</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Përmbyhet plotësisht</b>	<b>Përmbyhet kryesisht</b>	<b>Përmbyhet pjesërisht</b>	<b>Përmbyhet jo</b>
				X

*Beq* *Shkollë*



## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Ekonomiks” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti EPOKA”

### **Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit ju ofron studentëve njohuri të thelluara në fushën e “Ekonomiksit”, nxit mendimin kritik mbi teoritë ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm, dhe i aftëson ata për punë kërkimore të pavarur në këtë fushë.
2. Angazhimi në mësimdhënie i personelit akademik me kualifikim të lartë, eksperiencia ndërkombëtare dhe kontribute në veprimtarinë kërkimore shkencore.
3. Zbatimi i procedurave transparente dhe konkurruese për rekrutimin e personelit të cilat garantojnë për zgjedhjen e personelit akademik dhe ndihmës akademik me nivelin e kërkuar të kualifikimit.
4. Zbatimi i metodave inovative të mësimdhënies, trajnimi i stafit për përdorimin e tyre duke adresuar nevojat dhe vlerësuar efektivitetin e tyre
5. Marrëveshje bashkëpunimi efektive me universitete perëndimore, me vendeve të rajonit, si dhe me institucione publike dhe private në vend, të cilat kanë ndikuar në rritjen e mobiliteteve dhe pjesëmarrjen e departamentit në projekte.
6. Fond i pasur i bibliotekës së institucionit, që zgjerohet vazhdimisht, nëpërmjet procedurave të blerjeve sipas kërkesave të personelit akademik të programit. Akses në bibliotekat për personelin akademik dhe studentët.
7. Sistemi funksional i menaxhimit të informacionit (EIS) dhe Sistemi i Menaxhimit të Mësimin (LMS), me module të integruara dhe efektive, në shërbim të përdoruesve të ndryshëm, si personelit akademik, studentëve, personelit ndihmës akademik dhe atij administrativ.
8. Mjedise të përshtatshme, me kushte optimale dhe të pajisura me teknologjinë bashkëkohore në shërbim të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
9. Ofrimi i Bursave të meritës si një instrument nxitës për regjistrimin e studentëve me rezultatete të larta në këtë program studimi dhe që ndikon në numrin e studentëve të regjistruar në program.
10. Përfshirja e studentëve në veprimtarinë kërkimore me personelin akademik dhe mbështetja për publikimin e punimeve të tyre ose marrjen pjesë në konferenca.
11. Politika nxitëse financiare për personelin akademik, të cilat mbështesin pjesëmarrjen në konferenca, publikimin e artikujve shkencor dhe pjesëmarrjen në projekte.
12. Sistem efektiv i sigurimit të cilësisë, me struktura dhe përgjegjësi të qarta, që përdor instrumenta të ndryshëm, që i shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë si dhe krijimit të kulturës së cilësisë në nivel institucioni.



## **Pika të Dobëta**

1. Mungesa e praktikës profesionale pamundëson aftësimin praktik të studentëve dhe lidhjen e tyre me tregun e punës.
2. Numër i vogël studentësh nga rënia e regjistrimeve për shkak të ndryshimeve demografike dhe rritjes së konkurrencës.
3. Akses i limituar në burimet ndërkombëtare të literaturës në fushën e ekonomiksit, databazave dhe aksesit në revista shkencore.
4. Mungesa e një studimi tregu të dedikuar për këtë program studimi.

## **Rekomandime**

1. GVJ rekomandon që institucioni të riorganizojë planin mësimor sipas kërkesave të VKM 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".
2. GVJ rekomandon që Departamenti i Ekonomiksit të kryejë një studim të dedikuar tregu për këtë program studimi, në të cilin të jepen rekomandime konkrete se si mund të rritet numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi.
3. Numri i kufizuar i studentëve dhe burimet financiare në dispozicion nuk justifikojnë investimin në aksesin në literaturën dhe databazat ndërkombëtare online. Një zgjidhje do të ishte ndërhyrja e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për të mundësuar aksesin në shkallë kombëtare.

## **Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program "Master of Science in Economics" at the Higher Education Institution "EPOKA University"**

### **Strengths and affirmations**

1. The study program provides students with in-depth knowledge in the field of "Economics", fosters critical thinking on economic theories and sustainable development, and equips them with skills for independent research work in this field.
2. Engagement of highly qualified academic staff, with international experience and contribution to scientific research.
3. Implementation of transparent and competitive procedures for staff recruitment which guarantee the selection of academic staff and assistants with the required level of qualification.
4. Implementation of innovative teaching methods, assessment of needs for staff training, staff training for the use of such methods and evaluating their effectiveness.



5. Effective cooperation agreements with Western universities, with countries in the region, as well as with public and private institutions in the country, which have increased staff mobility and the department's participation in projects.
6. A rich library, which is constantly expanding, through acquisition procedures according to the requirements of the academic staff of the program.
7. Improved and functional Management Information System (MIS) and Management Learning System (LMS), with integrated and effective modules, used by academic staff, students, and the respective supporting staff.
8. Suitable facilities, with optimal conditions and equipped with modern technology in the service of teaching and scientific research.
9. Offering Merit Scholarships as an incentive for the enrollment of students with high results in this study program, which has affected the number of students enrolled in the program.
10. Involvement of students in research activities with academic staff and support for the publication of their research papers or participation in conferences.
11. Financial incentives policy for academic staff, supporting their participation in conferences, publication of scientific papers and participation in projects.
12. Effective quality assurance system, with clear structures and responsibilities, which use different instruments, and contribute to the continuous improvement of quality as well as the creation of a culture for provision of quality services at the institution level.

### **Weak points**

1. The lack of professional practice prevents on-the-job training of students and their skills matching to the labor market.
2. Small number of students from declining enrollments due to demographic changes and increased competition.
3. Limited access to international sources of economics literature, databases and access to scientific journals.
4. Lack of a dedicated market study for this study program.

### **Recommendations**

1. EEG recommends for the institution to reorganize the curriculum according to the requirements of VKM 41, dated 24.01.2018 "On the elements of study programs offered by institutions of higher education".
2. EEG recommends for the Department of Economics to conduct a dedicated market study for this study program, in which concrete recommendations are given on how to increase the number of students enrolled in this study program.
3. The limited number of students and the available financial resources do not allow for reasonable investment on access to international online literature and databases in the field. One solution would be the intervention of the Ministry of Education and Sports to enable access on a national scale.



### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

*Bulq Elshaj*